

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6077
E hënë, 3 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Hoti premtan mbështetjen e qeverisë për zhvillimin e Dragashit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PA SHBA-në NUK KA MARRËVESHJE FINALE ME SERBINË



Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se nuk ka marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa përfshirjen e ShBA-së në fazën finale të dialogut. Ata kanë thënë se për të ndodhur njohja reciproke në mes të dy shteteve, prania amerikane në këtë proces është e domosdoshme. Edhe partnerët e koalicionit dhe PDK-ja i kanë kërkuar kryeministrit Avdullah Hoti që të insistojë në përfshirjen e ShBA-së në procesin e dialogut të Brukselit, i cili ka rifilluar në muajin e kaluar

ZEMAJ: ASHPËRSIMI I ZBATIMIT TË MASAVE ANTI-COVID DO TË VAZHDOJË

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se ashpërsimi i zbatimit të masave kundër Covid-19 do të vazhdojë. Gjatë fundjavës ai së bashku me inspektoratin qendror dhe atë lokal, mbështetur nga Policia e Kosovës, kanë dalë në terren për të parë nga afër se sa po respektohen masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Ai ka thënë se nuk do të lejohet që nga të papërgjegjshmit të dëmtohet jeta dhe ekonomia e të gjithëve



INFERMIERËT SOT NË PROTESTË, KËRKOJNË PAGA MË TË LARTA PËR NDËRRIMIN E NATËS

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

UÇK-ja BËRI NJË LUFTË PËR TA ÇRRËNJOSUR NJËHERË E PËRGJITHMONË KRIMINALITETIN E SERBISË KUNDËR POPULLIT TË KOSOVËS (21) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



PROCESI I VJENËS I FSHEHUR BRENDË PROCESIT TË BRUKSELIT? F. 10

Milazim
KRASNIQI



LUFTA PËR LUFTËN F. 12-13

Shefqete
GOSALCI



AKTUALE

KURTI NË ATHINË PARAQET VIZIONIN E VET PËR BALLKANIN PERËNDIMOR F. 6

EKONOMI

ZEKA: DO TË KETË RËNIE TË TË HYRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2020 F. 8

815 ÇIFTE TË SHKURORËZUARA NË KOSOVË NË VITIN 2019, SHUMICA PAS NJË VITI MARTESË F. 8

SPORT

FERONIKELI ME TOVËRLANIN KËRKON RIKTHIMIN E TROFEVE F. 16

Lirohet veterani i UÇK-së që u ndalua nga policia e Shqipërisë

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka njoftuar se autoritetet e Shqipërisë e kanë liruar ish-luftëtarin e UÇK-së, Murtez Kastrati, i cili është ndaluar sot nga policia shqiptare, pas një kërkesë që Serbia kishte dërguar në Interpol. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se nga homologu i vet shqiptar, Gent Cakaj, është njoftuar se Kastrati është ndaluar për verifikim dhe është liruar para dy orësh. "Me të lexuar njoftimin nga z. Hysni Gucati, rreth ndalimit të ish-luftëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Murtez Kastrati, kam

kontaktuar menjëherë homologun shqiptar z. Gent Cakaj, i cili ka vepruar shpejt dhe ka sqaruar që z. Kastrati është ndaluar për verifikim dhe liruar para dy orësh. Është e papranueshme se si Serbia shtiret ndërkombëtarisht për kinse 'konstruktivitet' ndaj Kosovës, ndërsa porsa mbyllen dyert e të ashtuquajturit dialog, vazhdon veprimet ilegale kundër Kosovës", ka shkruar ajo, duke shtuar se kërkesat e Serbisë përmes Interpolit duhet të azhurnohen nga autoritetet e Shqipërisë duhet ta reflektojnë realitetin politik e ligjor të Kosovës. "Do të angazhohemi bashkë me

organizatat e dala nga lufta që menjëherë Qeveria, respektivisht MPJD-ja dhe MPB-ja e Republikës së Kosovës, t'u vë në dispozicion autoriteteve të Shqipërisë, listat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në bashkëpunim të ngushtë me homologun Cakaj, do të veprojmë konform kompetencave tona ligjore e kombëtare, që të mos lejojmë turpërimin e maltretim të shqiptarëve para kërkesave të tilla jolegjitime dhe joligjore të Serbisë. Përkrahja e vlerave të UÇK-së dhe pastërtisë së saj nuk është vetëm çështje deklarash!", ka shkruar Haradinaj-Stublla.



Studiuesit rusë thotë se do ta nisin prodhimin e vaksinës kundër Covid-19 në muajin nëntor

MOSKË, 2 GUSHT - Studiuesit e njërës prej dy vaksinave potenciale që po zhvillohen në Rusi kundër koronavirusit kanë thënë se janë në pritje të miratimit të autoriteteve për vaksinën e tyre dhe se janë duke planifikuar që ta nisin prodhimin e saj në muajin nëntor. Këto pretendime të institutit shtetëror "Vektor" janë në kundërshtim me disa paralajmërime të zyrtarëve rusë se një program i vaksinimit kundër sëmundjes Covid-19, që e shkakton koronavirusin, do të nisë në tetor.



Institutit Kërkimor Shtetëror "Vektor", Rinat Maksyutov, ka thënë të dielën se ky institucion planifikon që ta nisë

prodhimin e vaksinës në muajin nëntor. "Ne presim që ta nisim prodhimin në nëntor të këtij viti", ka thënë ai, raporton "Tass". Ai ka thënë se që nga viti i ardhshëm mund të nisin dhënien e kësaj vaccine. "Pra, kah fundi i këtij viti dhe në fillim të vitit të ardhshëm ne mund të flasim për dhënien e vaksinës, të paktën për njerëzit që konsiderohen grupe të rrezikuara dhe më pas të kalojmë në vaksinim masiv", është shprehur Maksyutov. Por, zyrtarët rusë, në vazhdimësi kanë thënë se vaksina kundër koronavirusit do të jetë e qasshme më herët.

Ministri i Shëndetësisë, Mikhail Murashko, është zotuar se Rusia do të nisë një fushatë të vaksinimit në masë kundër koronavirusit në muajin tetor. Ai ka thënë se të parët që do të vaksinohen do të jenë mësuesit dhe profesionistët shëndetësorë. Sipas të dhënave, në Rusi të paktën 849 mijë persona janë infektuar dhe mbi 14 mijë të tjerë kanë vdekur nga koronavirusi. Aktualisht në botë janë duke u zhvilluar mbi 100 vaksina potenciale kundër koronavirusit. Ky virus në nivel global ka mbytur të paktën 685 mijë persona, ndërsaq janë infektuar mbi 17 milionë.

Basha mbledh Kryesinë dhe Këshillin Kombëtar, pritet miratimi i komisionit të kandidatëve për deputetë

TIRANË, 2 GUSHT - Sot (e hënë) demokratët do t'i mbledhin forumet më të larta vendimmarrëse, Kryesinë dhe Këshillin Kombëtar të Partisë Demokratike (PD), të cilët do të vendosin për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Kandidatëve. Komisioni do të ketë 5 persona në përbërjen e tij dhe do të asistohet nga sekretariati ndihmës i komisionit i përbërë nga dy persona. Komisioni i Vlerësimit do ta bëjë seleksionimin e kandidatëve të propozuar për deputetë. Deri tani janë zbuluar emrat e dy prej themeluesve të PD-së, Genc Rulit dhe Besnik Mustafajt, të cilët do të jenë pjesë e këtij procesi unik, që ndodh për herë të parë në

Shqipëri. PD-ja ka thënë se përzgjedhja e kandidatëve për deputetë dhe kryebashkiakë do të bëhet sipas modelit të konservatorëve britanikë, të cilët kanë asistuar partinë e Lulzim Bashës së bashku me republikanët amerikanë dhe CDU-në e Angela Merkelit. Ky model është votuar në Kuvendin Kombëtar të demokratëve bashkë me ndryshimet statutorë. Propozimet e tjera ende nuk janë bërë publike, por komisioni është konceptuar që të ketë në përbërje jo vetëm ish-drejtuës të lartë të PD-së, por edhe personalitete të shoqërisë civile dhe medias, përfaqësues të botës akademike etj. Ky komision bën vlerësimin e çdo



kandidati, nëse përmbush apo jo kriteret e parashikuara me detaje në udhëzimin për funksionimin e procesit. Korpusi i njerëzve me influencë, me mbështetje, me aftësi në fusha të ndryshme, që do të përzgjidhen nga komisioni, do t'i shkojnë më pas për votim anëtarësisë së Partisë Demokratike. Nga procesi gjashtëjavor i propozimit të emrave, janë identifikuar një numër i lartë kandidatësh në të 12 qarqet. "Top Channel" pak javë më parë ka raportuar se baza kishte propozuar rikthim të emrave me kontribut në PD dhe zëra kritik si Jozefina Topalli. Ka edhe propozime jashtë strukturave të partisë, kryesisht nga bota akademike dhe shoqëria civile.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka inspektuar nga afër zbatimin e masave

Zemaj: Ashpërsimi i zbatimit të masave anti-Covid do të vazhdojë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se ashpërsimi i zbatimit të masave kundër Covid-19 do të vazhdojë. Gjatë fundjavës, së bashku me inspektoratin qendror dhe atë lokal, mbështetur nga Policia e Kosovës, Zemaj me ta ka dalë në terren për të parë nga afër se sa po respektohen masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Ai ka thënë se nuk do të lejohet që nga të papërgjegjshmit të dëmtohen jeta dhe ekonomia e të gjithëve



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë inspektime në terren për të parë nga afër se sa po respektohen masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Ai ka treguar se pas inspektimeve, për shkak të mosrespektimit të masave, janë gjobitur dhe mbyllur shumë kafiteri. "Mbrëmë, bashkë me inspektoratin qendror dhe atë lokal, mbështetur nga Policia e Kosovës, isha në terren për të parë nga afër ashpërsimin e zbatimit të masave, të cilin e paralajmëruam gjatë ditës. Pas inspektimit, për shkak të mosrespektimit të masave, u gjobitën dhe u mbyllën shumë kateteri. Ky ashpërsim i zbatimit të masave do të vazhdojë!", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka kërkuar nga bizneset që t'i zbatojnë masat për parandalimin dhe përhapjen e Covid-19. "Prandaj, për ta ruajtur shëndetin dhe jetët tuaja, kërkoj nga të gjitha bizneset dhe qytetarët që t'i zbatojnë masat për parandalimin dhe përhapjen e Covid-19, përndryshe do të ketë ndëshkime. Lufta për ruajtjen e shëndetit publik nuk është luftë vetëm e institucioneve dhe e mjekëve, por e të gjithëve!", ka shkruar ai.

Të dielën ai ka vizituar edhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ku ka thënë se nuk do të lejohen që të papërgjegjshmit t'i dëmtojnë jetët dhe ekonominë e të gjithëve. "Për të siguruar ambient të sigurt për ardhje dhe vajtje të bashkatdhetarëve, së bashku me inspektorët dhe drejtues të Policisë së Kosovës, sot kam vizituar Aeroportin e Prishtinës. Ndërkohë, inspektorët dhe policia kanë

vazhduar inspektimin edhe në pishina, qendra tregtare e kafeteri. Janë gjobitur dhe mbyllur të gjitha bizneset që nuk i kanë respektuar masat kundër Covid-19. Ashpërsimi i zbatimit të masave do të vazhdojë. Nuk do të lejohet që nga të papërgjegjshmit të dëmtohen jeta dhe ekonomia e të gjithëve", ka shkruar Zemaj në profilin e tij në "Facebook".

13 të vdekur dhe 245 raste të reja me koronavirus

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se në 24 orët e fundit 13 persona me koronavirus kanë vdekur dhe 245 raste të reja janë shënuar nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 468 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 245 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 8 799 raste nga 37 411 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 249 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera

shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 133 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve deri më sot është gjithsej 4 863 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 687", ka treguar IKShPK-ja.

Sipas institutit, rastet pozitive janë nga: komuna e Prishtinës 71 raste, komuna e Podujevës 24 raste, komuna e Gjilanit 18 raste, komuna e Gjakovës 15 raste, komuna e Mitrovicës 14 raste, komuna e Pejës 14 raste, komuna e Ferizajt 11 raste, komuna e Vushtrrisë 11 raste, komuna e Prizrenit 9 raste, komuna e Fushës Kosovës 8 raste, komuna e Klinës 7 raste, komuna e Istogut 6 raste, komuna e Deçanit 5 raste, komuna e Dragashit 5 raste, komuna e Lipjanit 5 raste, komuna e Vitisë 5 raste, komuna e Drenasit 3 raste,

komuna e Skenderaj 3 raste, komuna e Suharekës 3 raste, komuna e Malishevës 2 raste, komuna e Obiliqit 2 raste, komuna e Shtimes 2 raste dhe me nga një rast komunat e Graçanicë dhe Kaçanikut.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te

qytetarët, bizneset, gastronomi, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmit, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventuale të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut. Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

Thaçi i pikëlluar për vdekjet e qytetarëve nga virusi Korona

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se është i pikëlluar me vdekjet në ditët e fundit si pasojë e infektimit me virusin Covid-19. Po ashtu, Thaçi e ka quajtur të trishtë lajmin për vdekjen e Adem Latifit, vëllait të kryetarit të

Rahovecit, Smajl Latifit. "Më kanë pikëlluar shumë vdekjet e qytetarëve tanë në ditët e fundit si pasojë e infektimit me virusin Covid-19. I trishtë ishte lajmi edhe për vdekjen e Adem Latifit, vëllait të kryetarit të Rahovecit, Smajl Latifit.

Familjes Latifi dhe gjithë atyre që i kanë humbur familjarët e tyre u shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta. Lutem për shërim sa më të shpejtë të të gjithë të prekurve të tjerë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Përfshirja e ShBA-së në dialogun e Brukselit, e domosdoshme

Pa ShBA-në nuk ka marrëveshje finale

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se nuk ka marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa përfshirjen e ShBA-së në fazën finale të dialogut. Ata kanë thënë se për të ndodhur njohja reciproke në mes të dy shteteve, prania amerikane në këtë proces është e domosdoshme. Edhe partnerët e koalicionit dhe PDK-ja i kanë kërkuar kryeministrit Avdullah Hoti që të insistojë në përfshirjen e ShBA-së në procesin e dialogut të Brukselit, i cili ka rifilluar në muajin e kaluar

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Partnerët e koalicionit qeverisës, opozita dhe njohësit e rrethanave politike në vend, kanë kritikuar qasjen e kryeministrit Avdullah Hoti në procesin e dialogut në Bruksel. Ata kanë kërkuar përfshirjen e menjëhershme të ShBA-së në këtë proces. Sipas tyre, nuk ka marrëveshje për njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë pa përfshirjen e ShBA-së në fazën finale të dialogut.

Analisti politik Albinot Maloku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pa një rol aktiv të ShBA-së çdo dialog është i pakuptimtë. "Roli i ShBA-së duhet të jetë crucial në dialogun e Kosovës me Serbinë, pavarësisht angazhimit të BE-së. Prania e ShBA-së në të gjitha proceset e dialogut ka qenë e rëndësishme vitale ngaqë edhe pala e Kosovës ka pasur më shumë besim në procese me praninë e saj. Aktualisht nuk ka ndonjë sinjal për prani të ShBA-së në bisedimet e drejtuara nga

koordinatori i qeverisë aktuale të Kosovës me Serbinë dhe kjo me siguri nga fakti i mosseriozitetit dhe fuqisë së qeverisë aktuale të vendit. Pa rolin e ShBA-së çdo dialog është i pakuptimtë", ka thënë Maloku. Sipas tij, asgjë në këtë proces nuk mund të marrë formë pa ShBA-të. "Nuk kam besim në mundësinë e arritjes së ndonjë marrëveshjeje në mes të Kosovës e Serbisë pa rolin dhe praninë e ShBA-së. Asgjë nuk mund të marrë formë pa ShBA-në. Qeveria aktuale e Kosovës edhe vetë e di se dialogu aktual nuk ka asnjë peshë veç një pune që duhet ta bëjë ajo me këtë koordinatori të qeverisë", ka thënë Maloku.

Ndërsa analisti tjetër politik Albert Krasniqi ka bërë me dije që së fundi ka pasur moskoordinim në mes të ShBA-së dhe BE-së për procesin e dialogut. "Krahas mungesës së koordinimit ndërmjet ShBA-së dhe BE-së për procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duket se ka pasur edhe një lloj të

rivalitetit se kush po e merr primatin në këtë proces. Për më keq, është vërejtur edhe një lloj mosharmonizimi ndërmjet politikave të administratës së presidentit Trump me ato të Departamentit të Shtetit, si përfshirja e ShBA-së, të cilën liderët e Kosovës me ngulm e kanë kërkuar, ashtu edhe BE-ja është shumë e rëndësishme për ta mundësuar marrëveshjen dhe garantuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tani", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se Kosova nuk duhet të ketë preferencë në raport me ShBA-në dhe BE-në. "Kosova nuk duhet të ketë qasje preferenciale ashtu siç ka ndodhur kohën e fundit. Për presidentin Thaçi duket se administrata Trump ka qenë më e preferuar, kurse ish-kryeministri Kurti ka pasur preferencë për BE-në", ka thënë ai.

Edhe partnerët e koalicionit qeverisës, AAK-ja dhe Nisma, i kanë kërkuar kryeministrit Avdullah Hoti që të insistojë në përfshirjen më të madhe të ShBA-së në këtë proces.



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka deklaruar për "Epokën e re" se nuk mund të ketë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë pa ShBA-në. "AAK-ja si gjithmonë angazhohet për dialog që do të përfundonte në njohje reciproke dhe marrëveshje përfundimtare ligjërish të obligueshme. Dyshimet që ka përcjellë AAK-ja te partneri i koalicionit janë se ne po frikësohemi se Bashkimi Evropian po na kthen në vitin 2011, kur bisedohej për çështje teknike dhe jemi të bindur se nuk mund të ketë marrëveshje

pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Këto sugjerime të AAK-së nuk duhet të shihen si kërcënime për koalicionin, por si këshilla që të drejtohem në rrugën e duhur ku garantohej përmbyllja përfundimtare e problemeve Kosovë - Serbi", ka thënë Lekaj. Sipas tij, pa praninë e ShBA-së nuk ka garanci që marrëveshja do të arrihet shpejt. "Kryeministri Hoti në dialog duhet të shkojë për ta marrë njohjen e Serbisë duke u bazuar në Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe në asnjë formë të hyjë në një dialog të pafund që do ta linte Kosovën në status kohe

"Dialogu po zhvillohet në rrethana të pafavorshme për Kosovën"

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Instituti për Afirmimin e Marrëdhënieve Ndëretnike (IAMN) ka bërë një analizë dhe hulumtim të gjendjes aktuale politike lidhur me dialogun Kosovë - Serbi me mbështetjen e Brukselit. Ky institut, i cili drejtohet nga Fatmir Sheholl, ka theksuar se procesi i rifilluar i dialogut pas plot 20 muajve suspendim, është duke zhvilluar në rrethana shumë të pafavorshme për Kosovën. "Në skenën politike të Kosovës nuk kemi konsensus as politik e as shoqëror rreth dialogut. Opozita e Kosovës (LV-ja dhe PDK-ja) deri tani nuk kanë treguar kurrfarë shenje të bashkëpunimit rreth kësaj teme, bile edhe partia e pushtetit aktual - AAK-ja - po tregohet dyshuese rreth dialogut! Në këto rrethana, kur kësaj i shtojmë edhe propozim-maktakuzat e Prokurorisë së Dhomave të Specializuara në

Hagë ndaj presidentit të shtetit dhe kryetarit të PDK-së, shohim se gjendja e shtetit të Kosovës është shumë e lënduar! Parashtrrohet pyetja në emër të kujt po dialogun kryeministri Avdullah Hoti? Realisht, kryeministri Hoti po dialogun me Serbinë në emër të qeverisë që ai po e udhëheq (LDK+AAK+N i s m a + A K R + L i s t a Serbe+komunitetet e tjera) ai vetë. Mirëpo parashtrrohet pyetja, a e përfaqëson kryeministri Hoti në këto bisedime në Bruksel edhe Listën Serbe? Hulumtimi ynë tregon se kryeministri Hoti nuk përfaqëson mendimin dhe vendimin politik të Listës Serbe, që dmth. se de facto Avdullah Hoti nuk përfaqëson shumicën e thjeshtë parlamentare, por përfaqëson vetëm mendimin e më së shumti 50 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, bile nganjëherë (përkujtojmë deklaratat e



kreut të AAK-së) as edhe 40 deputetët!", është thënë në analizën e IAMN-së, duke shtuar se LDK-ja e ka të detyrueshme ta konsultojë njëherë nga partitë opozitare për çështjen e dialogut.

"Ky moment shumë delikat na shpie të konkludojmë se kësaj qeverie i nevojitet pashmangshëm dhe gjithsesi një partner i fuqishëm politik nga opozita! PDK-ja tregoi se kur është interesi nacional (rishikimi i

buxhetit) atëherë del mbi interesa të veta partiake dhe i nënshtrohet popullit! Tash, LDK-ja si kryesuese e qeverisë aktuale është e detyrueshme dhe obliguese që njëherë prej dy partive opozitare, e pse jo mundësisht të dyja (PDK-ja dhe LV-ja) t'i konsultojë dhe të bisedojë hapur për mundësinë e krijimit të një konsensusi të gjerë politik për ballafaqim me Serbinë! Zoti Hoti është kryeministër, por nuk është lider parti-

ak dhe realisht nuk i takon atij që të thërrasë takime të 'Forumit politik' për krijimin e një uniteti politik! Është më se e nevojshme që këtë iniciativë ta marrë presidenti i vendit që, edhe pse në situatë çfarë është, duhet të tregojë vendosmëri në këto rrethana për të treguar unitet kombëtar!", është thënë në analizën e IAMN-së.

Instituti për Afirmimin e Marrëdhënieve Ndëretnike (IAMN) nga 20 qershori deri më 25 korrik të këtij viti ka realizuar hulumtimin me 1 001 respondentë shqiptarë, nga i cili ka rezultuar se 87 për qind e të anketuarve mendojnë se Kosova nuk duhet fare të dialogojë me Serbinë pa praninë amerikane. "13 për qind mendojnë se duhet të vazhdojë dialogun në Bruksel! Tash mbetet që qeveria aktuale ta gjejë formulën adekuate shtetërore për më tutje!", është thënë në analizën e IAMN-së.

Dialogu me Serbinë



amerikanëve është e domosdoshme në dialog. Nuk ka marrëveshje në Ballkan që është arritur pa përfshirjen e amerikanëve, e sidomos tash në raportin Kosovë - Serbi. Roli i amerikanëve është kyç. Ata janë edhe në Këshill të Sigurimit të OKB-së. Ata mund të na japin mbështetje në OKB”, ka thënë Hoxhaj.

Ndërsa koordinatori shtetëror i Kosovës për dialogun me Serbinë, Skender Hyseni, mendon se ShBA-ja është e përfshirë mjaftueshëm në dialog. Para nisjes për një vizitë disaditore për në Uashington, ai ka thënë se përfshirja e ShBA-së në këtë proces do të jetë gjithnjë e më e evidente. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë tashmë të përfshira dhe do të jenë në mënyrë aktive të përfshira, si dhe kjo përfshirje do të bëhet gjithnjë e më e evidente. Sa për një informim paraprak, unë nesër udhëtoj për në Uashington D.C., ku gjatë dy-tre ditëve do të zhvilloj takime të nivelit të lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit, por edhe në Shtëpinë e Bardhë, me qëllim të vetëm dhe, pas marrëveshjes me Departamentin Amerikan të Shtetit, që të koordinojmë, të pajtohemi, t’i ndajmë vlerësimet për procesin dhe t’i koordinojmë ndërveprimet dhe veprimet e mëtejme rreth dialogut”, ka thënë Hyseni për “Radion Evropa e Lirë”.

dhe, siç duket, pa praninë e ShBA-së nuk ka garanci që marrëveshja do të arrihet shpejt, andaj z. Hoti duhet të jetë më shumë insistues për praninë amerikane në tavolinën e dialogut”, ka deklaruar Lekaj.

Edhe PDK-ja si parti opozitare mendon se ShBA-ja duhet të ketë rol kyç në dialogun për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ish-ministri i Punëve të Jashtme nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se përfshirja e amerikanëve në dialogun Kosovë -Serbi është e domosdoshme. “Përfshirja e

Infermierët sot në protestë, kërkojnë paga më të larta për ndërrimin e natës



PRISHTINË, 2 GUSHT - Sindikata e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë, sot (e hënë), me një protestë simbolike, do t’i kërkojë Qeverisë së Kosovës rritjen e pagesës së ndërrimeve të natës. Lajmin e ka bërë me dije sekretari i kësaj sindikate, Enlirat Duraku, i cili ka thënë se kërkesat e tyre nuk po merren parasysh nga ekzekutivi. “Sindikata e Infermierëve dhe Mamive me kohë ka parashtruar kërkesën për rrit-

jen e pagesës për ndërrimin e natës për infermierë, mami e profesionistë shëndetësorë edhe tek institucionet relevante. Kjo kërkesë ka mbetur e pashqyrtuar. Tani ne jemi detyruar që ta organizojmë një protestë simbolike paqësore sepse vendi ynë po kalon periudhën e pandemisë. Protesta do të fillojë në orën 10:00 dhe do të jetë protestë simbolike”, ka thënë ai për “EO”. Ai ka theksuar se propozimet që janë bërë në emër të komu-

nitetit, të infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë nuk paraqesin vullnet sepse, sipas institucioneve të vendit, nuk janë konsultuar me ta. “Sinjerisht propozimet që po bëhen në emër të komunitetit infermier, mami dhe profesionistë shëndetësorë nuk paraqesin vullnetin sepse nuk jemi të konsultuar, mirëpo nëse do të ishim të konsultuar, secili do ta jepte kontributin e vet”, ka thënë ai.

Në kohë pandemie, qytetarët po përballen edhe me gripin sezonal

PRISHTINË, 2 GUSHT - Në kohën e pandemisë Covid-19 tashmë kanë filluar të shpërfaqen edhe simptomat e infektimit me virusin sezonal, të cilat janë të ngjashme me koronavirusin. Dallimi mes këtyre viruseve, sipas profesionistëve shëndetësorë, është se koronavirusi i ri është më i ashpër se viruset sezonale, pikërisht për shkak të përhapjes së shpejtë që ka. Ndërsa sa iu përket simptomave, ka ngjashmëri, si ethe, temperaturë, dhimbje fyti, të vjella, diarre, kokëdhimbje etj. Profesionistë shëndetësorë kanë thënë se numri i pacientëve nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare ka filluar të rritet, krahas numrit të të infektuarve me koronavirus. Ajo çka mbetet sfida është identifikimi i sëmundjes, në këtë rast virusit sezonal nga ai i koronavirusit, që shkakton sëmundjen Covid-19.

Doktoresha familjare, Ilire

Bunjaku, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se shumë simptoma të gripit sezonal janë të ngjashme me ato të Covid-19. Megjithatë, jo çdo pacient me shenja të koronavirusit e testojnë. Andaj, siç ka thënë doktoresha Bunjaku, ka lëshime edhe nga ana e mjekëve dhe sfida mbetet të simptomat e njëjta mes virusit sezonal dhe koronavirusit. “Ajo çka po vërejmë është rritja e numrit të pacientëve që po kërkojnë ndihmë dhe çdo simptomë po e lidhin me Covid-19, andaj edhe numri i pacientëve është rritur kohët e fundit. Problem mbetet detektimi i saktë i virusit. Ndërkohë që për të bërë një test për Covid-19, pacienti duhet ta ketë temperaturën mbi 38.5 dhe faturimi i oksigjenit të jetë nën 95 për qind. Përndryshe e vlerëson mjeku, por që ka lëshime edhe nga ana e pacientëve, por edhe nga ana e mjekëve, pasi



simptomatologjia pothuajse është e njëjtë”, ka thënë Bunjaku.

Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, gjatë vitit 2019 kanë qenë 16 000 raste të regjistruara me grip sezonal. Viti 2018 ishte

përmbyllur me 11 persona të vdekur nga gripit sezonal, për ç’gjë autoritetet kishin shpallur atëbotë gjendjen epidemike të gripit. Për vitin 2019 nuk kanë të dhëna për vdekje të personave me grip sezonal.

Lindita Ajazaj, drejtoreshë e

Klinikës Infektive, ka thënë se për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, ndonëse ka pacientë me simptomat e virusit që tentojnë të kërkojnë ndihmë në Klinikën Infektive, aty tashmë ka të shtrirë vetëm pacientë pozitivë me Covid-19.

Komuna e Skenderajt pranon donacion 150 teste për Covid-19

SKENDERAJ, 2 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim afaristin Ilir Hajzer Seferi, i cili jeton dhe vepron në Gjermani. Gjatë

këtij takimi, Jashari ka bërë me dije se Seferi ka përkrahur këtë komunë me 150 teste për Covid-19. "Iliri ka përkrahur komunën tonë në këtë situatë pandemike

disa herë, kurse sot dhuroi 150 teste për diagnostifikimin e infeksionit Covid-19 dhe 5 termometër", ka treguar Jashari. Jashari në emër të qytetarëve

të komunës tonë ka falënderuar Ilir Seferin për donacionin dhe përkrahjen e vazhdueshme dhënë komunës dhe qytetarëve të Skenderajt.



Diaspora, më 'dorëlirore' gjatë pandemisë

PRISHTINË, 2 GUSHT - Linda Zejnullahu, rreth 25 vjeçe, që jeton në Komunën e Shtimes, me vite të tëra pranon mjete financiare nga xhaxhai i saj i cili jeton në Gjermani, të cilat i shfrytëzon për shkollim. Mbështetja e tij për të ka vazhduar edhe gjatë kohës së pandemisë së koronavirusit. "Mua personalisht më ka dërguar para për shkollim deri në 100 euro në muaj. Gjatë kohës së pandemisë i ka dërguar para edhe familjes sime, 300 euro në muaj. Paratë i ka dërguar vetëm për qejf, pasi unë dhe disa familjarë punojmë në Kosovë", ka thënë Linda.

Dërgesat e qytetarëve të Kosovës që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të botës ishin të pashmangshme edhe gjatë pandemisë Covid-19, me gjithë faktin se pandemia ka prekur edhe shtetet ku punojnë dhe jetojnë emigrantët nga Kosova. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti vlera e remitencave ka arritur në 433 milionë apo 28 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të



kaluar. Kështu ka thënë të mërkurën, më 29 korrik, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në një konferencë për media, ku ka bërë me dije vendimin për mbulimin e shpenzimeve nga ana e qeverisë për Kartonin e Gjellbër për mërgimtarët që vijnë në Kosovë.

Ndërsa sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), vetëm në muajin maj të këtij viti vlera e parave të mërgimtarëve me prejardhje nga Kosova që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit ka qenë 100,7 milionë euro, ndërsa në muajin maj të vitit të kaluar kjo vlerë ka qenë 78,4 milionë euro.

Përfaqësues të shoqërisë civile theksojnë se diaspora ka reaguar shpejt me remitencat për t'i ndihmuar familjet e tyre në Kosovë për shkak të pasojave që ka shkaktuar pandemia në buxhetin familjar të tyre.

Lirim Krasniqi, hulumtues dhe analist i politikave në organizatën "Germin", që merret kryesisht me çështje të diasporës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se edhe vendet ku është e koncentruar diaspora e Kosovës janë të prekura nga pandemia e koronavirusit por, siç thotë ai, ata kanë shfrytëzuar kursimet e tyre financiare. "Edhe kjo vërehet nëse i shikojmë kanalet e dërgimit të

remitencave. Shihet se shuma më e madhe e parave kanë ardhur përmes agjencive për transferim të shpejtë. Kjo tregon se rritja e nivelit të remitencave ka ardhur si reagim i diasporës për t'i ndihmuar familjet me të ardhurat e tyre në Kosovë, të cilët janë prekur nga pandemia", ka thënë Krasniqi. Sipas të dhënave të BQK-së, nga shuma e përgjithshme e dërgesave prej 100.7 milionë eurosh, në muajin maj të këtij viti 88,6 milionë euro janë dërguar përmes agjencive për transferim të mjeteve, kurse përmes bankave komerciale që operojnë në Kosovë, janë dërguar 12.2 milionë euro. Përveç remitencave të dërguara për familjet e tyre, nga diaspora e Kosovës janë grumbulluar mbi 716 mijë euro në llogarinë e dedikuar të Thesarit, si mbështetje financiare për luftimin e koronavirusit që shkakton sëmundjen Covid-19. Ndihma nga diaspora ka ardhur pas thirrjes që u ka bërë mërgimtarëve ish-kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 12 prill të këtij viti.

Drejtori i përgjithshëm i

Thesarit të Kosovës, Ahmet Ismaili, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", tha se llogaria është ende aktive. "Kjo nuk ka qenë llogari vetëm për bashkatdhetarët. Kjo është llogari për donacione dhe grante. Normalisht se kontributin më të madh e ka dhënë diaspora e Kosovës që jeton në vende të ndryshme të Evropës dhe botës", ka thënë Ismaili. Numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deri në fund të vitit 2018 vlerësohet të jetë mbi 850 mijë banorë. Ekonomia e Kosovës vazhdon të ketë një varshmëri të madhe nga remitencat apo dërgesat e qytetarëve të Kosovës që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të botës. Në vitin 2019 vlera e remitencave ishte mbi 800 milionë euro. Këto mjete përgjatë viteve kanë pasur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, duke nxitur rritjen ekonomike dhe duke siguruar të ardhura shtesë për familjet me të ardhura më të ulëta.

Sot planifikohet të hapen çerdhet në Gjilan

GJILAN, 2 GUSHT (ER) - Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 është njoftuar për rastet më të reja pozitive me virus, ndërkohë që kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka kërkuar nga qytetarët t'i respektojnë masat anti-Covid në mënyrë që të ulen rastet e infeksionit dhe që të mund të ndërmerren veprime për t'i lehtësuar masat. Në të kundërtën, ai ka thënë se nëse shtohen rastet e të infektuarve dhe i atyre që përfundojnë me vdekje, do të duhej ashpërsuar ato. Më tutje, Haziri ka vlerësuar lart mjekët në

gjinekologji, ku ka pasur një lindje të suksesshme të një fëmije të shëndoshë nga një nënë e cila ka qenë me Covid-19. Pas procedurave, ajo është liruar në shtëpi në vetizolim. "Ju lutem, ruajeni pak veten tuaj, familjen tuaj dhe të tjerët në këtë situatë, në mënyrë që të mos detyrohemi t'i shtrëngojmë masat. Ky është shqetësimi im i vazhdueshëm sepse rritja e numrit të të infektuarve dhe i rasteve të vdekjes do të na detyrojë t'i shtrëngojmë masat", ka thënë kryetari Haziri.

Megjithatë, Haziri ka paralajmëruar lehtësim të

masave, duke përmendur faktin se që nga sot (e hënë) do të hapen çerdhet, fitneset, sallat e sporteve edukuese. "Të hënë po planifikojmë t'i hapim çerdhet. Ende nuk kemi konfirmim se cilat çerdhe në çfarë kohe, por në kuadër të lehtësimit të masave ftoj menaxhmentin e çerdheve, edhe publike edhe private, që të përgatiten. Ne do t'i hapim çerdhet, sallat e sportit edukues, fitneset...", ka thënë Haziri, duke shtuar se për Klubin e Futbollit "Gjilani" dhe "Drita" do të krijojnë kushte të veçanta për përgatitje sepse ato klube do



të na përfaqësojnë në Evropë. Ai ka kërkuar nga qytetarët të vazhdojnë të bashkëpunojnë me institucionet që ta

përballojmë sa më lehtë gjenden me Covid-19 dhe që të kemi sa ma shumë lajme të mira.

Breshëri dëmtoi kulturat bujqësore në disa fshatra të Drenasit



DRENAS, 2 GUSHT (ER) - Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut dhe të breshrit, në disa fshatra të Komunës së Drenasit janë shkaktuar dëme të mëdha në shumë kultura bujqësore, objekte banimi, sera dhe gjësende të tjera. Për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara

nga fatkeqësitë natyrore, ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Arberije Gllareva dhe stafi i kësaj drejtorie, kanë qenë në terren për të evidentuar dhe monitoruar gjendjen faktike në vendbanimet ku janë shkaktuar

dëme nga breshëri. Dëmet në të mbjellat bujqësore, vetura e objekte banimi janë kryesisht në fshatin Kizhnarekë, Komoran, Fushticë e Ulët dhe e Lartë dhe Zabel i Lartë. Në bazë të kërkesave të cilat do të adresohen nga të dëmtuarit, komisioni komunal për

vlerësimin e dëmeve do të dalë në terren për t'i vizituar ato ekonomi familjare që janë dëmtuar dhe, pas vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, do ta hartojë raportin përfundimtar të cilin do të përcjellë në nivelin qendror për mundësinë e kompensimit.

Haziri: Kritikant ndaj qeverisë Hoti kanë pasur qëllime të mira

PRISHTINË, 2 GUSHT - Nënkrjetari i LDK-së, njëherësh kryetar i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se kritikant që ia ka dhënë qeverisë e cila drejtohet nga bashkëpartia i tij, Avdullah Hoti, kanë qenë qëllimmira. Haziri është shprehur se ka kërkuar reagim më agresiv të menaxhimit të pandemisë pasi, sipas tij, kjo situatë nuk mund të menaxhohet me politika të buta, çfarë bën kryeministri Hoti. Sipas tij, kjo mënyrë e qeverisjes është vlerë e tij si person, e marrë edhe



nga LDK-ja. Haziri, i cili ka qenë shumë i ashpër ndaj qeverisë lidhur me menaxhimin e pandemisë madje, sipas mediave, ai e kishte vlerësuar "katastrofal" ditë më parë punën e qeverisë në menaxhimin e pandemisë, ka thënë se aktivizimi i Planit Kombëtar nga qeveria është ajo çfarë ai ka kërkuar. "Nuk është kritikë dashakeqe, është kritikë qëllimmirë, sepse z. Hoti edhe si politikan edhe si njeri aplikon qeverisje të butë, që është vlerë e tij, dhe këtë e ka marrë nga LDK-ja.

Pandemia kërkon agresivitet në menaxhim. Më vjen mirë që qeveria ka marrë vendim për aktivizimin e Planit Kombëtar. Pandemia nuk mund të menaxhohet vetëm me Ligjin e Infeksioneve sepse është i ngushtë dhe i pamjaftueshëm t'i zgjidhë problemet", është shprehur Haziri për "EO". Nënkrjetari i LDK-së ka thënë se është kundër ndalimit të qarkullimit të qytetarëve pasi, sipas tij, edhe modeli që ka përdorur qeveria Kurti ka qenë i pamjaftueshëm dhe i dështuar.

IKShPK-ja bën thirrje për kujdes ndaj virusit të Nilit Perëndimor

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes ndaj virusit të Nilit, edhe pse në Kosovë, sipas këtij instituti, nuk është shfaqur asnjë rast me këtë virus. Sipas IKShPK-së, virusi i Nilit Perëndimor, që transmetohet kryesisht te njerëzit përmes pickimit të mushkonjave, mund të shkaktojë sëmundje neurologjike te njerëzit. Virus i Nilit Perëndimor (VPN) është

shfaqur në Ballkan? Në Kosovë nuk ka të sëmurë, por rreziku ekziston andaj kujdes nga pickimi i mushkonjave! Virus i Nilit Perëndimor mund të shkaktojë sëmundje fatale neurologjike te njerëzit. Megjithëse përafërsisht 80 përqind e njerëzve që janë të infektuar nuk tregojnë asnjë simptomë. Virus i Nilit Perëndimor transmetohet te njerëzit kryesisht nëpërmjet pickimit të mushkonjave. Virus mund të shkaktojë sëmundje të rëndë dhe ngordhje të kuajve.

Vaksinat për përdorim te kuajt janë në dispozicion për përdorim, por jo ende në dispozicion për njerëzit. Zogjtë janë bartës natyralë të virusit të Nilit Perëndimor. VNP mund të shkaktojë sëmundje neurologjike dhe vdekje të njerëzve. VNP zakonisht gjendet në Afrikë, Evropë, Lindjen e Mesme, Amerikën Veriore dhe Azinë Perëndimore. VNP është ruajtur në natyrë nëpërmjet ciklit i cili përfshinë transmetimin në mes zogjve dhe mushkonjave. Njerëzit,



kuajt dhe gjitarët e tjerë mund të infektohen", ka njoftuar IKShPK-ja. Simptomat e këtij virusi, sipas IKShPK-së, përfshijnë: temperaturë, dhembje koke, lodhje dhe dhembje të trupit, të vjella, herë pas here skuqje të lëkurës

dhe ënjtje të gjëndrave limfatike. "Punëtorët shëndetësorë që kujdesen për pacientët e dyshuar apo të konfirmuar me infektion VNP, ose që punojnë me mostrat prej tyre, duhet t'i zbatojnë masat standarde parandaluese për kontrollin e infeksioneve. Mostrat e marra prej njerëzve ose kafshëve të dyshuara me infektion VNP duhet të manipulohen nga stafi i trajnuar dhe në laboratorë të pajisur komplet", ka njoftuar ky institut.

Policia arreston katër persona dhe mbyll pishina e lokale për mosrespektim të masave

PRISHTINË, 2 GUSHT - Në Gjakovë, Rahovec dhe Skenderaj, Policia e Kosovës raporton se gjatë 24 orëve të fundit ka arrestuar persona që nuk kanë respektuar masat e vendosura nga autoritetet për ta frenuar përhapjen e mëtejme të koronavirusit dhe ka mbyllur lokale. Sipas raportit 24-orësh të policisë në Gjakovë, në katër

raste të ndara janë arrestuar katër persona të cilët kishin organizuar ahengje familjare. Me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit, Qeveria e Kosovës ka ndaluar të gjitha tubimet publike, përfshirë ahengjet familjare private, si dhe grumbullimin e më shumë se pesë personave në sheshe publike, parqe e të tjera. Ndërsa



në Rahovec një pronar i një pishine është dërguar në stacion policor për intervistim, pasi në pishinën e tij policia ka

vërejtur 30-40 qytetarë. Rast i ngjashëm ka ndodhur edhe në Skenderaj, ku policia ka zbratur pishinën, ku kishte qytetarë dhe pronarin e ka ftuar për intervistim në stacion. Sipas masave të reja, pishinave të hapura u është ndaluar aktiviteti, por kjo masë nuk vlen për pishinat e mbyllura, të cilat mund të punojnë, në përputhje

me rekomandimet e Manualit të Ministrisë së Shëndetësisë për luftën kundër koronavirusit. Kurse në Skenderaj policia ka mbyllur dy lokale, pasi kishin punuar jashtë orarit të lejuar. Sipas vendimit të qeverisë të datës 28 korrik, lokalet e gastronomisë e kanë të ndaluar që të punojnë pas orës 22:30 deri në orën 5:00.

Kurti në Athinë paraqet vizionin e tij për Ballkanin Perëndimor

ATHINË, 2 GUSHT (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka marrë pjesë në simpoziumin shkencor "Pandemia: Bota pas Covid-19", i cili është mbajtur në Athinë të Greqisë. Kurti në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se në këtë simpozium ka paraqitur qëndrimet dhe vizionin e vet për Ballkanin Perëndimor, duke përshkruar e shpjeguar në veçanti përballjen katërmujore të qeverisë së tij

kundër pandemisë. "Pandemia: Bota pas Covid-19" ishte sivjet tema e Symbiosiumit i cili u mbajt për 22-n herë, kësaj radhe në Athinë të Greqisë. Personalitete të shquara politike, akademike e humanitare nga Evropa morën pjesë fizikisht, por edhe nga mbarë bota nëpërmjet platformës 'Zoom', në panele të shumta me prezantime të vlefshme e diskutime interesante. Përgjatë kësaj jave që po e

lëmë pas, aty u trajtuan shumë çështje e tema: nga qëndrueshmëria e institucioneve dhe komuniteteve në kohë krize e deri te ekonomia e gjelbër dhe intelijenca artificiale. Unë kam paraqitur qëndrimet dhe vizionin për rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor duke përshkruar e shpjeguar në veçanti përballjen katërmujore të qeverisjes sonë të mirë në disa fronte njëkohësisht", ka shkruar Kurti.



OAK-u: Punëdhënësi dhe punëmarrësi të trajtohen në mënyrë të barabartë, shteti ta marrë përsipër barrën e pushimit të lehonisë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Oda e Afarizmit e Kosovës ka ripërsëritur kërkesën për plotësim-ndryshimin e Ligjit të Punës dhe Ligjin e Pushimit të Lehonisë të ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica. Sipas një njoftimi, OAK-u ka adresuar propozimet lidhur me plotësim-ndryshimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit të Pushimit të Lehonisë, të cilat janë krijuar pas hulumtimeve dhe diskutimeve me bizneset. Siç është thënë në këtë njoftim, në këtë kërkesë është theksuar neni 34 i Ligjit të Punës, i cili thotë se "punonjësi e ka të drejtën e shkëputjes së kontratës së punës në mënyrë të njëanshme" dhe "punonjësi me kontratë me afat të caktuar për shkëputjen e kontratës, duhet ta informojë

punëdhënësin paraprakisht në formë të shkruar në afatin prej 15-ditësh, ndërsa për kontratat me afat të pacaktuar, paralajmërimi i shkëputjes së kontratës është 30 ditë paraprake". Me këtë rast, Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka kërkuar që për kontrata me afat të caktuar, paralajmërimi i dorëheqjes apo largimit nga puna të jetë 30 ditë për të dyja palët, ndërsa për kontratat me afat të pacaktuar, paralajmërimi i dorëheqjes apo largimit nga puna të jetë 90 ditë për të dyja palët.

Gjithashtu, sipas nenit 42, i cili thotë se "nëse kontrata e punës shkëputet, sipas nenit 35 barra e provës mbetet mbi punëdhënësin", ku në këtë rast mund të vërehet që në rast se punëtori largohet nga puna pa paralajmërim, nuk ka asnjë



ndëshkim, ndërsa kur punëdhënësi e largon punëtorin pa paralajmërim, mund të gjobitet deri në vlerën 40 mijë euro.

Në këtë kërkesë është përmendur dhe Ligji i Pushimit të Lehonisë, ku Oda e Afarizmit e

Kosovës (OAK) ka kërkuar që pagesa e pushimit të lehonisë të mbulohet 100 për qind nga shteti. "Duke pasur parasysh se Kosova është vendi me papunësinë më të madhe në rajon dhe shkallën e punësim-it të femrave prej 12.6

përqindësh nga 600 mijë femra në moshë pune, OAK-u e konsideron se kjo është një nga arsytet e papunësisë së tyre pasi që shumë biznese hezitohet të punësojnë femra në momentin që e konsiderojnë se në të ardhmen ata duhet të paguajnë 70 % të pagës bazë për 6 muaj, njëkohësisht të paguajnë një punëtor/e të ri/re për të njëjtin vend të punës", është thënë në njoftimin e OAK-ut.

Në fund të kërkesës së dërguar, Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka kërkuar nga ministri Skender Reçica që të merren parasysh këto propozime duke i cilësuar të nevojshme për ndryshime në njërin anë për punëdhënësit dhe punëmarrësit, po ashtu për rritjen e punësim-it të femrave.

Zeka: Do të ketë rënie të të hyrave buxhetore për vitin 2020

PRISHTINË, 2 GUSHT - Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se është shumë herët të flitet për ndikimin që ka pasur pandemia në vendet e punës. Sipas tij, duhen pritur të dhënat zyrtare nga anketa të fuqisë punëtore apo edhe të dhënat zyrtare të cilat do të paraqiten nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në muajt në vazhdim. "Sa i përket punësim-it, është shumë herët të matet ndikimi që pandemia ka pasur në vendet e punës. Megjithatë, duhet të presim për të dhëna zyrtare qoftë nga anketa e fuqisë punëtore e cila përgatitet nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) apo edhe të dhëna zyrtare të cilat do të prezantohen nga Administrata Tatimore e Kosovës në muajt në vijim. Edhe pse është herët që ndonjëra prej ndërmarrjeve të ketë deklaruar më pak punonjës



sesa që ka pasur para pandemisë, interesant do të jenë të dhënat edhe sa i përket qarkullimit të bizneseve përgjatë tre muajve të kaluar dhe besoj se do të jenë gati pas datës 20 korrik kur deklarohet tatimi mbi vlerën e shtuar", ka thënë Zeka. Ai ka theksuar se si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia do të ketë rënie të të hyrave buxhetore për vitin

2020. "Tash efektet e pandemisë janë gjithëpërfshirëse dhe kanë goditur sektorin privat për shkak të masave të kufizuara me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë, por në anën tjetër, derisa shënojmë rënie në Bruto Produktin Vendor, domosdoshmërisht do të ketë rënie të të hyrave buxhetore për vitin 2020", ka thënë ai.

Mes të tjerash, Zeka ka thënë se Kosova është në një situatë të vështirë sa i përket zbatimit të pakos emergjente sepse ende nuk është aprovuar. Sipas tij, shteti ka dështuar që t'ua japë mbështetjen e duhur ndërmarrjeve. "Tashmë jemi në një situatë dëshpërimit sepse zbatimi i parë nga pakoja emergjente fiskale është vonuar dhe nuk kemi parë ende aprovimin e projektligjit të rimëkëmbjes sepse ky ligj do të bënte të mundur edhe zbatimin e masave nga pakoja e rimëkëmbjes. Presim që të përfundojë rishikimi buxhetor. Këtu çdo kritikë është për deputetët të cilët kanë gjetur të bëjnë politikë për tema të tjera që unë konsideroj se në këtë situatë janë të natyrës dytësore. Ekonomia është parësore për momentin dhe të gjithë përpjekjet tona duhet të jenë të fokusuar te rimëkëmbja. Shteti ka dështuar që t'i japë

përkrahje ndërmarrjeve. Disa prej bizneseve kanë protestuar për të drejtën e tyre", ka thënë Zeka.

Më tutje, Zeka ka thënë se parasheh edhe tërheqjen e kursimeve pensionale të 10-përqindëshit të mjeteve të kursimit. Pavarësisht vonësës që është bërë në aprovimin e marrëveshjeve, Zeka ka thënë se është për t'u mirëpritur fakti që janë aprovuar marrëveshjet ndërkombëtare. "Po ashtu, parashihet edhe tërheqja e kursimeve pensionale të 10-përqindëshit të këtyre mjeteve të kursimit pensional. Tërheqja e këtij 10-përqindëshi ka mbetur një alternativë e pranueshme dhe është një çështje e ndjeshme. Pavarësisht vonësës që është bërë në aprovimin e këtyre marrëveshjeve, është për t'u mirëpritur fakti që janë aprovuar marrëveshjet ndërkombëtare", ka deklaruar Zeka.

815 çifte të shkurorëzuara në Kosovë në vitin 2019, shumica pas një viti martesë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e shkurorëzimeve në Kosovë 2019", ku është bërë me dije se në gjykatat themelore të Kosovës janë grumbulluar gjithsej 815 fleta për shkurorëzime. Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë në vitin 2019 janë shkurorëzuar 815 çifte bashkëshortore. Sipas kohëzgj-

atjes së martesës, dominonte viti i parë me 13.1 për qind, viti i dytë me 12.9 për qind dhe më pak se një vit 9.9 për qind e të shkurorëzuarve. Në shkurorëzimet sipas grupmoshave, dominonin femrat e moshës 25-29 vjeç me 178 shkurorëzime apo 21.8 për qind, kurse te meshkujt dominonte mosha 30-34 vjeç me 192 apo 23.6 për qind e rasteve. Sipas përgatitjes

shkollore, dominojnë femrat dhe meshkujt me shkollë të mesme, ku numri i femrave të kësaj kategorie është 304 apo 37.3 për qind, kurse i meshkujve 338 apo 41.5 për qind. Numri më i madh i bashkëshortëve të shkurorëzuar janë pa fëmijë me 74.5 për qind, pastaj vijnë me dy fëmijë me 9.6 për qind dhe me një fëmijë me 9.3 për qind.



Hoti premtion mbështetjen e qeverisë për zhvillimin e Dragashit

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar disa biznese në Komunën e Dragashit, në mesin e tyre edhe kompaninë "Meka", të pronarit Burim Piraj. Aty Hoti ka premtuar se do t'u dalë në ndihmë bizneseve me pakon për rimëkëmbje ekonomike, përmes së cilës do të lehtësohet marrja e kredive dhe financimi për bizneset. Po ashtu, Hoti ka premtuar mbështetje edhe për zhvillimin e Dragashit

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

DRAGASH, 2 GUSHT (ER) - Kryeministri i Qeverisë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në kuadër të vizitave që është duke ua bërë komunave të vendit, të dielën ka vizituar Komunën e Dragashit. I shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, ministri Arban Abrashi, Vesel Krasniqi dhe Besian Mustafa, kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, deputetë të zonës, si dhe përfaqësues institucionale të nivelit qendror dhe lokal, kryeministri Hoti fillimisht ka inspektuar punimet në rrugën Zhur - Dragash. Me këtë rast, kryemi-

nistri Hoti ka thënë se kjo rrugë është e rëndësishme nacionale, një projekt me dy lote që shkon afër 7 milionë euro. "Ka pasur mjaft vonesa, disa teknike e disa procedurale, por besoj se ministri është duke u kujdesur që të rritet dinamika dhe të përmbyllet ky projekt në afatin optimal", ka thënë kryeministri Hoti, duke theksuar se rruga është e rëndësishme së veçantë, sepse lidh tërë këtë trevë edhe për çështje të turizmit, edhe të blegtorisë, por edhe për lidhje me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kryeministri Hoti ka thënë se kjo infrastrukturë kompletion tërë kushtet e nevojshme që të zhvillohet më mirë turizmi dhe të lehtësohet jeta e qyte-

tarëve. "Dragashi ka një diasporë të fuqishme të komuniteteve të ndryshme dhe besoj se kjo rrugë ndihmon në këtë drejtim", është shprehur Hoti.

Më pas, kryeministri Hoti ka vazhduar vizitën në fabrikën për përpunimin e mishit "MEKA", ku është pritur nga pronari Burim Piraj, i cili e ka njoftuar kryeministrin për sukseset dhe sfidat që ka kjo kompani. Hoti e ka përgëzuar pronarin Piraj për "biznesin e shëndoshë dhe me standardet më të mira të cilësisë dhe të etikës në punë". Po ashtu,

kryeministri Hoti ka thënë se do të shihen mundësitë për ta ndihmuar këtë biznes edhe me pakon për rimëkëmbje ekonomike, përmes së cilës do të lehtësohet marrja e kredive dhe financimi për bizneset.

Vizitën e radhës në Dragash, kryeministri e ka bërë në fermën "Qendra", ku është pritur nga pronari Masar Piraj dhe fabrikën e tekstit "Inversione" të pronarit Ezxhan Emmini, të cilëve u ka premtuar se qeveria do t'u qëndrojë afër, duke i mbështetur të gjitha bizneset në veprimtarinë e

tyre. Në fund të qëndrimit në Dragash, kryeministri Hoti ka zhvilluar një takim me fermerët e zonës së Gorës në fshatin Krushevë, të cilët kërkuar nga kryeministri mbështetje për investimet në këtë zonë, duke theksuar se turizmi malor dhe infrastruktura janë të domosdoshme për këtë rajon. Ndërsa kryeministri Hoti ka thënë se qeveria do t'i mbështesë banorët e kësaj zone për zhvillimin e turizmit malor nëpërmjet subvencioneve dhe granteve si dhe për përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme.

Rukiqi thotë se deri në 50 mijë qytetarë mund ta humbin vendin e punës shkaku i pandemisë

PRISHTINË, 2 GUSHT - Si pasojë e pandemisë Covid-19, deri në 50 mijë qytetarë të Kosovës mund ta humbin vendin e punës. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi. Ai ka thënë se në mënyrë që vendet e punës të mos shuhën, intervenimi i Qeverisë së Kosovës për t'i përkrahur bizneset është i domosdoshëm. "Nëse marrim parasysh shifrat e turrjes së mundshme ekonomike, sigurisht mund të flasim për një numër deri në 25 mijë vende pune që mund të humbin si pasojë e pandemisë. Kjo është në variantin më pozitiv e mund të shkojë deri në 50 mijë e më



shumë, varësisht nga kohëzgjatja e pandemisë, por në të njëjtën kohë edhe nga menaxhimi i pandemisë në përgjithësi, nga kufizimet që mund t'i krijojë pandemia dhe masat që do t'i ndërmarrë qeveria", ka thënë Rukiqi, duke treguar edhe për humbjet që ua

ka shkaktuar pandemia bizneseve në Kosovë. "Ne mund të kemi një përlogaritje të saktë që është diku deri në 10 milionë euro në ditë humbje në periudhën kur ka qenë e mbyllur pothuajse e gjithë ekonomia, pra po flasim për periudhën 13 mars deri më 1 qershor, por

nuk kemi të dhëna të sakta për periudhën pas 1 qershorit e deri më sot, kur formalisht kemi hapje të ekonomisë, por kemi rënie të dukshme të qarkullimit. Ndoshta në fund të muajit shtator do të kemi një pasqyrë më të saktë. Aty do t'i shohim edhe raportimet financiare të bizneseve dhe vlerësimet e bizneseve. Por, mund të themi që kemi rënie të qarkullimit, kemi mungesë të konfidencës të konsumatorit që jeton në Kosovë që nuk shpenzon, qoftë se nuk del të shpenzojë duke e pasur frikën edhe të infektimit, ose ka një lloj pasigurie për të ardhmen, prandaj heziton të shpenzojë. Por, kemi edhe një mungesë të qarkullimit që vjen drejtpërsë-

drejti nga mungesa e vizitave të diasporës. Pra, rënia e fuqisë blerëse ka ndikuar në çdo sektor. Ndoshta nuk kemi një vlerësim të saktë të humbjeve, por nëse i shohim parashikimet që janë diskutuar edhe në institucionet financiare ndërkombëtare dhe lëvizjet në tregje, Kosova mund të ballafaqohet me një turrje ekonomike deri në 7 për qind. Qeveria e Kosovës ka shkuar në një version më pozitiv 3 për qind, por nëse flasim në vlera të caktuara, humbjet mund të sillen jo më pak se 500 milionë euro në Bruto Produktin Vendor dhe mund të jenë edhe më të larta nëse nuk merren masa adekuate për rimëkëmbjen ekonomike", është shprehur Rukiqi.

Manaj: S'ka pushim për Kuvendin pa u miratuar ligji për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Shkëmb Manaj, ka thënë se ligji për rimëkëmbjen ekonomike është jetik për qytetarët dhe bizneset e vendit në këtë kohë të mbijetesës për shkak të pandemisë. Prandaj, sipas tij, Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike duhet

të shqyrtohet dhe aprovohet në procedurë të përspejtuar në Kuvendin e Republikës. Në këtë kontekst, Manaj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nuk do të përfundojë sesioni pranveror i Kuvendit pa miratimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike. "Ligji për rimëkëmbjen ekonomike

është jetik për qytetarët dhe bizneset e vendit tonë në këtë kohë të mbijetesës për shkak të pandemisë. Prandaj, Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në procedurë të përspejtuar në Kuvendin e Republikës, në mënyrë që punëtorët dhe bizneset ta

përfundojnë dorën e shtetit në këto çaste kur ata janë duke u ballafaquar me vështirësi dhe shteti duhet të jetë pranë tyre. Nuk ka përmbyllje të sesionit pranveror dhe shkuarje në pushim të Kuvendit pa u përfunduar Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike", ka shkruar Manaj.



Procesi i Vjenës i fshehur brenda procesit të Brukselit?



Milazim KRASNIQI

Nga ajo që është bërë me dije deri sot, episodi i ri i dialogut në Bruksel është i paketuar me të njëjtën skemë me Procesin e Vjenës në vitin 2007. Tash është më pak teatral sesa atëherë por, në esencë, paraqet të njëjtin rrezik që Kosova të mbetet shtet pa substancë dhe pa e përmbyllur as këtë herë statusin e njohjes nga Serbia dhe nga bota.

Pse mund të thuhet kështu? Kështu mund të thuhet në bazë të asaj që është bërë e njohur nga përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës, Skender Hyseni. Ai ka thënë se në këtë dialog do të diskutohen tema të veçanta, por nuk do të ketë marrëveshje të veçanta për to, sepse ato do të përfshihen në një marrëveshje të përbashkët. Pra, sipas tij, ose do të ketë marrëveshje për çdo gjë, ose për asgjë. Ata që kanë kujtesë, e mbajnë mend se me këtë skemë ka punuar edhe ekipi i Marti Ahtisarit dhe Albert Rohanit, në Procesin e Vjenës. Atje mbledheshin delegacionet e ekspertëve nga Kosova e Serbia, zhvilloheshin diskutime për tema konkrete, fjala vjen, për pushtetin komunal, për kishat serbe, etj., ndërsa ekipi i Ahtisarit prej tyre nxirrte konkluzionet dhe i

bënte propozimet për zgjidhje të atyre problemeve në një marrëveshje (plan) final. Me atë metodologji punoi ekipi i Ahtisarit dhe në fund e hartoi Planin, që iu paraqit palëve dhe sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, pra një marrëveshje e përgjithshme. Sikundër dihet, Serbia i mori favorët e shumta nga ai Plan për serbët e Kosovës, për temat e veçanta që u dhanë favore serbëve lokalë e Serbisë, ndërsa Planin e Përgjithshëm e refuzoi. Në atë proces dhe me atë metodologji të mashtruese, Kosova bëri kompromise të rënda, deri në masën sa realisht u shndërrua në shtet jofunksional, kështu si është sot, pa kontroll mbi veriun dhe me kontrollin faktik të serbëve mbi institucionet qendrore. Procesi i Vjenës mundësoi proklamimin e pavarësisë së Kosovës, por të një shteti të varur nga serbët dhe nga ndërkombëtarët. Meqë nga ai proces doli si shtet i gjymtë, kjo gjë i ka hapur rrugën Procesit malinj të Brukselit, ku Serbia tash synon të fitojë favore të tjera edhe më të mëdha. Kjo është skema në të cilën po luan Bashkimi Evropian dhe Serbia. Me të njëjtën metodë, duke u nisur nga çështjet e veçanta drejt demokracisë së zgjidhjes së përgjithshme, por e cila në fund nuk pranohet nga Serbia me ç'rast Kosova sërish mund të mbetet palë e dëmtuar, që merr obligime për zbatimin çështjeve të veçanta, pa e marrë njohjen. Me aq sa po shihet tash për tash kjo është

skema e Brukselit, brenda së cilës është e fshehur skema e Procesit të Vjenës.

Me këtë rast, duhet të mbahet në vëmendje se në procesin e ri pritet që Serbia të marrë favore edhe më të mëdha se sa në Procesin e Vjenës. Në këtë proces pritet që Serbia të shpëtojë nga padia për gjenocid, pritet që të fitojë bashkësinë e komunave serbe si entitet me ingerenca ekzekutive dhe pritet që Kosova të mbetet e varur ekonomikisht nga Serbia, jo vetëm me provizionet për Gazivodën e Trepçën, po edhe me energjinë dhe sistemet e tjera ekonomike, si dhe statusin problematik të qytetit të Mitrovicës.

Qeveria e Kosovës tash për tash është shumë e pasinqertë me publikun në qëndrimet e veta. Pse? Sepse formati, procesi, po as sfondi gjeopolitik, nuk japin asnjë indikacion se po dialogohet për njohje reciproke. Formatin, procesin dhe sfondin gjeopolitik, tash për tash kanë këto synime: 1. Bashkimi Evropian synon ta arrijë një marrëveshje me të cilën do të dilte me një "storie suksesi" para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, me të cilën do ta çmontonte një konflikt në oborrin e vet, por pa e zgjidhur plotësisht. Pra, synon ta çmontojë konfliktin, ashtu që Serbia të mbetet e kënaqur, ndërsa Kosova të mbetet e paafte që të kundërshtojë çkadoqoftë. 2. Serbia synon t'i hapë vetes rrugën drejt fondeve më të mëdha të

Bashkimit Evropian dhe t'i afrohet anëtarësimit, por pa e pasur vullnetin për anëtarësim të plotë edhe për disa vite, shkak i presioneve të Rusisë. 3. Kosova synon ta përmbyll pavarësinë, me iluzionin se kjo është e realizueshme me një proces jotipik për arritjen e njohjes.

Sa iu përket aktorëve të tjerë, ata janë afër procesit, por jashtë procesit. ShBA synon të arrihet marrëveshje ndërmjet Kosovës e Serbisë, me të cilën Kosova do të mbetet sferë e ndikimit të SHBA-së dhe të NATO-s, por pa e përjashtuar plotësisht influencën ruse, e pakta në veriun e Kosovës. Rusia synon ta mbajë krizën të hapur, ndonëse të ngrirë, gjë që i jep mundësi të jetë

prezente me metoda të presionit jo vetëm në Serbi e në rajon, po edhe ndaj Bashkimit Evropian, në rast se nxitë iniciativa për Krimenë ose për vetë Ukrainën. Me një fjalë, Procesi i Brukselit është vazhdim i atij të Vjenës, i cili mundësoi proklamimin e një shteti pa substancë dhe jofunksional, duke i mbajtur në lojë edhe ëndrrat serbe, po edhe taktikat ruse. Rrjedhimisht ky proces mund të çojë Kosovën drejt dështimit të mëtejshëm si shtet, ndërsa Serbinë drejt iluzionit të ri se po rikthehet hap pas hapi, (temë pas teme), në "tokën e shenjtë." Të tjerët janë në rolin e Ponc Pilatit, në instancë të fundit. Mjaftohen të kenë me çka t'i lajnë duart.



Roli i diasporës shqiptare në proceset politikëbërëse dhe ekonomike në Kosovë



Shkruan: Bekim BRESTOVCI

Diaspora shqiptare me origjinë nga Kosova u krijua ndër decenie si rezultat i gjendjes së rëndë ekonomike, përndjekjeve politike e represive si dhe nga gjenocidi e dëbimi masiv nga

trojet e tyre shekullore të ushtruar nga pushteti i Serbisë që datojnë që nga viti 1912 (shpërngulja e madhe e shqiptarëve në Turqi) e deri te dëbimi masiv gjatë luftës së fundit të viteve 1998-1999.

E shpërndarë thuaja në çdo cep të botës, diaspora jonë e mirintegruar në shtetet pritëse, shumë shpejt u bë bartëse e organizimeve të panumërta të cilat Kosovën e ndihmuan në organizimin e saj politik, në sensibilizimin e çështjes politike dhe aspiratave të popullit të Kosovës, në

funksionalizimin e sistemit paralel shtetëror të viteve '90 e deri në kontributin sublim për çlirimin e vendit përmes ndihmave materiale për luftën, por edhe përmes kyçjes së drejtpërdrejtë vullnetare në UÇK. Diaspora jonë, përveç ndihmave të mëdha përmes remitencave, dha deri më tani një kontribut të madh në rimëkëmbjen ekonomike të vendit duke investuar kapitalin e vet në shumë e shumë ndërmarrje prodhuese, ndërtimore, shërbyese e hoteliere, duke ndihmuar

kështu edhe zbutjen e papunësisë e cila është një ndër preokupimet kryesore të institucioneve të Republikës së Kosovës. Vitet e fundit, për krenarinë tonë, pjesëtarë të diasporës jo vetëm se po tregohen të suksesshëm në afarizëm, në sport, muzikë, në shkencë e shumë lëmenj profesionalë, por tanimë po bëhen edhe pjesë aktive në jetën politike në shtetet në të cilat jetojnë, duke marrë edhe pozita politike të avancuara. Sot, kur ne po e shënojmë Ditën e Diasporës, edhe pse këtë vit

për shkak të pandemisë dhe në shenjë të respektimit të rregullave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, pa ndonjë aktivitet të theksuar, në emër timin personal dhe nga funksioni im zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, urimit tim i bashkëngjis edhe zotimin tim për punë të palodhshme dhe angazhimin tim maksimal për krijimin e mundësive të një përfaqësimi dinjitoz të interesave dhe nevojave të Diasporës në Republikën e Kosovës.

UÇK-JA BËRI NJË LUFTË PËR TA ÇRRËNJOSUR NJËHERË E PËRGJITHMONË KRIMINALITETIN E SERBISË KUNDËR POPULLIT TË KOSOVËS (21)



Shkruan: Kudosu LAMA

“Ka rëndësi përfundimi se krimi i organizuar në Kosovë - Metohi, duke marrë strukturën dhe infrastrukturën e UÇK-së, është zhvilluar dhe degëzuar krahas me terrorizmin shqiptar dhe që tani paraqet një bazë materialo-financiare të qëndrueshme, por dhe ekspansive të lëvizjes terroriste-separatiste shqiptare në tërësi”.¹

Duket se sipas Serbisë paslufta meqenëse nuk lejoi të ishte më e të sundonte Serbia në Kosovë si dinte ajo, tashmë nuk do të kishte tjetër veçse terrorizëm dhe separatizëm shqiptar në tërësinë e shtrirjes kombëtare. Ku do të kishte vetëm ekspansionizëm. Po vërtetë a dihet se kush quhet ekspansionist? A quhet ekspansionist ai komb që lufton dhe punon të sundojë vetveten apo ai shtet e komb që lufton e bën masakra për të sunduar kombet e tjera? Këtë përgjigje është me vend ta japë zotëri Marty, i cili në raportin e tij ka shkruar gjithçka që shkruajnë serbët veçse duke u përpjekur të moderojë gjuhë.

Struktura dhe infrastruktura e UÇK-së do të jetë përjetësisht e pranishme në Kosovë, pasi ajo është struktura dhe infrastruktura e lirisë, duan apo nuk duna serbët dhe zotëri Marty.

“Në qershor të vitit 2003, Beri Fleçer, zëdhënës i policisë së UNMIK-ut në Kosovë - Matohi, në deklaratën për media ka thënë se një nga pengesat më të mëdha me të cilën ballafaqohen forcat e kombeve të Bashkuara, është thellësisht e rrënjosur mafia shqiptare, e cila përdorë parullat nacionaliste të shqiptarëve të Kosovë-Matohisë atëherë kur ato iu përgjigjen kërkesave të tyre. (“Çdo herë kur burgosnin ndonjë prej udhëheqësve gangsterë, ai mbështillej me flamurin shqiptar, kurse në rrugët shpërthenin demonstruesit. Kjo nuk ishte shoqëri e qëlluar me krimin e organizuar, por shoqëri e bazuar në krimin e organizuar”, deklaroi Fleçer”.²

Jam i sigurt se në qoftë se Beri Fleçer ka përdorur një gjuhë të tillë ai nuk është tjetër veçse një i dërguar i Serbisë, pasi populli shqiptar e di mirë se UNMIK-u në Kosovë nuk ka pasur demonstrata për mbrojtje gangsterësh, por për mbrojtje të luftëtarëve të arrestuar sipas paragjytimeve serbe, të cilët në përgjithësi në gjykimet e gjykatave ndërkombëtare kanë dalë në pafajësi.

Dhe ajo që duhet theksuar në këtë

moment është e vërteta se populli shqiptar në Kosovë nuk është një popull që do të largohet nga këto troje, por një popull që do ta gëzojë lirinë e tij aty në trojet e të parëve dhe që me gjithë vështirësitë e daljes nga një luftë e përgjakshme me pushtuesin do të ndërtojë gradualisht një jetë të begatë. Prandaj edhe shoqëria që ndërton me gjithë pretendimet që kemi për më mirë, do të jetë një shoqëri shqiptare e kulturuar dhe me ardhmëri, por pa pushtuesit serb sot e në shekujt e ardhshëm. UÇK-ja bëri një luftë finale pikërisht për të çrrënjosur njëherë e përgjithmonë kriminalitetin e Serbisë kundër popullit të Kosovës. Ajo as që do të lejonte të instalohen struktura kriminale në këto hapësira të vendit të tyre, i cili është larë me gjakun e djemve dhe vajzave luftëtarë, të cilët në frontet e luftës kundër pushtuesit shekullor serb, derdhen gjakun e tyre të pastër për të çimentuar lirinë e përjetshme të atdheut.

“Grupet e para të armatosura të UÇK-së në zonën e Drenicës i ka udhëhequr Adem Jashari nga Prekazi i Poshtëm, ndërsa anëtarët ishin kushërinjtë e tij më të afërt dhe më të largët, kryesisht persona të prirë për dhunë dhe kryerjen e veprimeve kriminale të imta. Më vonë atyre iu bashkuan ish-oficerë të Ushtrisë Popullore Jugosllave dhe pjesëtar të MPB të Serbisë me kombësi shqiptare, të cilët iu larguan besnikërisht ndaj shtetit dhe organeve të tij, si dhe pjesëmarrës të ndeshjeve të armatosura në trevat e Kroacisë dhe të Bosnje - Hercegovinës, ku kanë fituar përvojë luftarake”.³

Mirë që Serbia e di se grupet e para të armatosura të UÇK-së në zonën e Drenicës i ka udhëhequr Adem Jashari nga Prekazi i Poshtëm, por nuk thotë asgjë se si me ushtri masive ndërmori një operacion të posaçëm kompleks për të luftuar kundër Adem Jasharit, duke u vënë përballë fëmijëve e grave, pleqve e plakave, të cilët luftuan deri në pikën e fundit të gjakut, për t'i thënë jo Serbisë njëherë e përgjithmonë. Vërtet a ndihet krenare Serbia që duke luftuar kundër Adem Jasharit ka vlarë pleq e fëmijë? Besoj se ndihet shumë krenare përderisa nuk përmendet fare ky operacion i gjerë. Por me gjithë madhështinë e qëndrësës, me gjithë fuqinë e rezistencës, me gjithë jehonën e luftës kombëtarisht e ndërkombëtarisht, me gjithë rënien heroike të 56 luftëtarëve të moshave prej 80 e deri në 8 vjeç, Serbia përsëri ka guxim dhe i quan “persona të prirë për dhunë dhe veprimtari kriminale”. Kur lexon këtë vlerësim edhe njeriu më indiferent e kupton saktësinë e vlerësimit të Serbisë për shqiptarët dhe gjithçka që ndërmarrin ata për jetën dhe lirinë e tyre. A e dinë shqiptarët se në Luftën e Prekazit kanë marrë

pjesë 8 mijë trupa ushtarake e policore serbe me të gjitha llojet e armëve? A e dinë shqiptarët se në Luftën e Prekazit, organizimi i forcave serbe ishte në dy fronte, në frontin e brendshëm me 4 mijë trupa dhe në frontin e jashtëm me 4 mijë trupa? A e dinë shqiptarët se brenda unazës së frontit të brendshëm luftonin vetëm 60 luftëtarë të moshave të ndryshme deri edhe fëmijë? A e dinë shqiptarët se, çdo luftëtar i lirie brenda unazës së rrethimit i ka takuar të ketë përballë 67 luftëtarë serb të armatosur deri në dhembë? A e dinë shqiptarët se ata luftëtarë lirie bënë 3 ditë luftë? A e dinë shqiptarët se ata luftëtarë lirie rezistuan sa të ishin një perandori? Shqiptarë – përlunë përpara akteve të tilla të atdhetarisë, të cilët Lufta Çlirimtare e Kosovës i ka pasur të shumtë në të gjitha frontet e luftës prej fillimit e deri në mbarim.

“Megjithëse përbërja fillestare e këtij organizimi nuk e kishte reputacionin me të cilin të tërhiqte anëtarë të rinj, UÇK-ja, për një kohë relativisht të shkurtër, arriti të siguronte masivitet të rëndësishëm. Për këtë sipas serbëve “efekte pati edhe terrori i kryer nga ana e shtabeve terroriste vendore mbi pjesën “indiferente” të popullatës shqiptare. Duke organizuar të ashtuquajturat treshe, ekstremistët frekuentonin udhëheqësit e fiseve dhe i kërcënonin me likuidimin e disa anëtarëve të atyre familjeve, të cilat nuk do të jepnin përfaqësuesit e vet për repartet e UÇK-së (Ka ekzistuar edhe mundësia që pjesëmarrja në repartet e UÇK-së “është blerë”, me pagesë nga 2 deri 5 mijë marka gjermane (DEM) komandantit të vendit të UÇK-së, gjoja për nevojat e organizimit, edhe pse një pjesë e rëndësishme e këtyre mjeteve ka përfunduar në xhepat e privatëve). Forcimit të UÇK-së i kanë kontribuar edhe paratë e krimin, si dhe ndihma e diasporës shqiptare”.⁴

Me gjithë dashakeqësinë Serbia edhe kur është e detyruar të deklarojë një fakt të asaj kohe përpiqet ta njollosë në mënyrën më të ndyrë. Më sipër lexojmë: “UÇK-ja, për një kohë relativisht të shkurtër, arriti të siguronte masivitet të rëndësishëm”, që është një e vërtetë e pranuar ndërkombëtarisht. Gjithë bota ka pranuar se UÇK-ja është organizata guerile më e suksesshme në botë, që për një kohë shumë të shkurtër u njoh prej botës, u vlerësua prej saj, u pranuar si qytetare bashkëkohore e botës moderne dhe në përfundim kjo botë e madhe u bë bashkëluftëtare e saj që ajo të plotësonte detyrat e saj me dëmtime sa më të vogla në popullatën që mbronte prej armikut, duke ardhur në përfundimin e luftës me një fitore të përbashkët të UÇK-së dhe të

NATO-s.

Por ja që ky sukses nuk paska qenë sipas serbëve i merituar, sepse shtabet e UÇK-së paskan bërë presion mbi pjesën indiferente të popullatës shqiptare. E sa për sqarime për atë periudhë, me pahir e detyrim nuk lejohej të merrej askush në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi të marrët me mashtrim apo me presion gjithnjë të lënë pa përkrahje në situata të vështira luftarake e të lënë frontin bosh, pasi ikin, sepse ata nuk kanë ideal dhënien e jetës për atdhe e liri. Prandaj edhe UÇK-ja ka qenë ushtri vullnetare, ku kishte të drejtë të rreshtohet çdo shqiptar i gatshëm për sakrificë në emër të atdheut. Por këto shpifje të rinovuara në vitin 2010 nga Dick Marty, nuk do të kenë të ndalur, sepse realisht Serbia nuk mund të kuptojë lirinë e të tjerëve dhe çdo veprim kundër saj, pavarësisht se është i drejtë, do të ketë pas një skenar të ngritur me shumë mjeshtri për ta njollosur atë e për të krijuar një mjegullnajë që opinioni në vend të së vërtetës të pranojë gënjeshtren.

“Policia Gjermane, në mars të vitit 1999, ka konstatuar se rritja e tregtisë me heroinën, me të cilën në tregun e Gjermanisë, Zvicrës dhe vendeve skandinave merren shqiptaret, ka koinciduar me forcimin e shpejt të UÇK-së. Është vërtetuar se nga një ushtri fshatare e armatosur lehtë, siç ishte disa vjet më parë, UÇK-ja u zhvillua deri në forcë prej dhjetëra mijëra njerëzish, të pajisur me raketahedhëse, me armatim kundërtank dhe me pushke AK-47. (“The Times”, 24 mars 1999, teksti me titull “Paratë e drogës janë të lidhura me kryengritësit kosovarë” autorët janë korrespondentë nga Boni, Roxher Bojs dhe Eske Rajt”).⁵

Unë nuk ndjejë ndonjë trysni nga informacione të tilla, pasi e kam të njohur praktikën e Serbisë që shpifjet nuk i bën gjithnjë vetë, por në shumicë të rasteve blenë autorë të ndryshëm në vende të tjera, siç duket edhe rasti i këtyre dy gazetarëve që Serbia i njeh me dhembë e dhëmballë. Por ashtu siç duket në të gjitha pamjet edhe rasti i zotëri Marty, i cili ka ngritur një tajfun mashtrimesh me një raport voluminoz në emër të Evropës, por që është si dy pika uji me këtë libër të shkruar nga Serbia 6 vjet para raportit. Sidoqoftë, unë ndihem krenar që dikush atje në Gjermani e paska ditur se UÇK-ja ishte bërë një ushtri e fuqishme kur bota vendosi të bëhet partnere e saj në luftë kundër Serbisë. Se ka edhe këtu në Kosovë e në Shqipëri, që megjithëse i thonë vetes shqiptarë dhe flasin shqip, nuk arrijnë të kuptojnë atë që qenka kuptuar në Gjermani që në vitin 1999, e në Serbi komentuar në vitin 2004.

“Numrin më të madh UÇK-ja e ka pasur gjatë bombardimeve të

NATO-së kur nën armë u rreshtuan mbi 20.300 pjesëtarë. U formuan brigada, të cilat, pa bashkërendime të rëndësishme ndërmjet tyre, vepronin në shtatë zona operative - Drenica, Pashtriku, Dukagjini, Shala, Nerodimje dhe Karadak”.⁶ Me thënë të drejtën më duket interesant që Serbia në atë kohë paska pasur një informacion thuajse të saktë. Por meqë jemi këtu, dua të saktësoj plotësisht, se me fillimin e goditjeve të NATO-s, UÇK-së iu bashkëngjitën 19 mijë luftëtarë, të cilët i dhanë një hov të mëtejshëm luftës për liri dhe bashkëpunimit me NATO-n.

“Pas shpalljes zyrtare të çmilitarizimit të UÇK-së në tetor 1999, në intervale të ndryshme, në territorin e Kosovë - Metohisë janë regjistruar veprimtaritë e rreth 40 grupeve të armatosura të shqiptarëve, me nga 10 deri 300 anëtarë aktiv kryesisht nga radhët e ish-UÇK-së dhe persona të gatshëm për kryerjen e veprimeve kriminale. Një numër i madh i këtyre grupeve ishte i formuar me nismën ose angazhimin e drejtpërdrejtë të Rustem Mustafës, të quajtur “komandant Remi”, të Fatmir Humollit dhe të disa oficerëve të tjerë të K3K, por që veprojnë nën patronazhin e Hashim Thaçit, ose të ashtuquajturave shërbime sekrete shqiptare të formuara në Kosovë - Metohi”.

Gjithkush ka të drejtën të bëjë krahasimin e gjuhës së përbashkët të Serbisë dhe të zotëri Martyt. Fjalor, që duke u përpjekur të nxijë gjithçka, është i formuluar në atë mënyrë që të njollosë gjithë hapësirën e Kosovës. Por populli i njeh mirë edhe Rustem Mustafën edhe bashkëpunëtorët e bashkëluftëtarët e tij dhe nuk mund të zbehët portreti i tij me shpifjet serbe, përkundrazi, sa më shumë të shpif Serbia për djemtë e luftës, aq më i madh bëhet portreti i tyre në sytë e popullit shqiptar që i gëzohet lirisë, duke parë se Serbia është hedhur jashtë njëherë e përgjithmonë. (Vijon)

¹ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovarë”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 11, botimi serbisht

² Po aty, faqe 11

³ Obilić Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovarë”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 12, botimi serbisht

⁴ Obilić Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovarë”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 12 - 13, botimi serbisht

⁵ Po aty, faqe 13

⁶ Obilić Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovarë”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 13, botimi serbisht

LUFTA PËR LUFTËN

E kujt ishte lufta, e kujt është liria, e kujt harresa, e kujt kujtesa, e kujt historia dhe e kujt (pa)përgjegjësia? A kemi kujtesë?



Shefqete GOSALCI

Të dashur vëllezër e motra, të dashur miq e shokë, shqiptarët e mi të dashur,

Ju lus, në emër të të gjithë të vrarëve, të masakruarve të pafajshëm, nga Serbia gjenocidale, (të të gjitha periudhave), si dhe atyre të luftës së fundit në Kosovë (1998/99), të cilët i pamë me sy e i ndiejmë me shpirt, që t'i bëjmë (SUBSCRIBE) "YJET QË NUK VDESIN", në YOU TUBE, të autorëve Nusret Pllana dhe Esat Shala, të cilët janë mbledhës të fakteve dhe dokumenteve, argumenteve të krimeve të Serbisë mbi shqiptarët, në mënyrë që t'i shoh e gjithë bota dhe të bindet për monstruozeitetin dhe përmasat e gjenocidit dhe ta njohë të vërtetën tonë të dhimbshme historike.

Kujtesa si virtut do të duhej dhe duhet të na shqetësojë e të na obligojë, mbase edhe të na alarmojë të gjithëve, pa përjashtim, edhe si individë, edhe si institucione, që historinë tonë të lavdishme ta shkruajmë e ta ruajmë vetë, ta mbrojmë e ta arkivojmë.

Harresa, si ves (është si kujtimet), sot do të na dhembë më së paku krahasuar me dhimbjen dhe vuajtjet që do të mund t'ua sillte brezave në vazhdim.

Akademitë tona të Artit e të Shkencës, Instituti i Historisë i Tiranës dhe i Prishtinës, si institucionet më të larta shkencore, do të duhej ta kishin prioritet mbi prioritetet dokumentimin e krimeve shekullore serbe mbi shqiptarët, sepse atyre u takon t'i trajtojnë me prioritet temat kaq të mëdha siç është lufta dhe vlerat e saj. Çfarë mund të ishte më e rëndësishme për shkencën shqiptare sesa tema e luftës, tragjedisë kaq të madhe kombëtare dhe mbijetesës? Ata kanë kapacitete shkencore, financiare dhe organizative për hulumtime të tilla. Le ta bëjnë sot. Ndryshe do të kuptohej dhe vlerësohej një libër i tillë i botuar nga dy akademitë tona.

Përderisa Serbia (shtet gjenocidal, që brenda 30 vjetëve të fundit bëri tri luftëra në Ballkan, vrau e masakroi qindramijëra njerëz të pafajshëm) ka mbushur arkivat, rrjetet sociale

dhe ka shkruar libra të mbushura me rrena, trillime e të pavërteta për shqiptarët dhe të njëjtat, të përkthyer në shumë gjuhë të botës, i ka botuar në miliona kopje dhe i ka shpërndarë nëpër ambasada të shumë shteteve dhe të njëjtat i shpërndanë e i shet nëpër panairt e librave kudo nëpër botë, ka ndotur informimin e drejtë dhe të vërtetë për shqiptarët jo vetëm në Serbi, por në gjithë botën. Mos të harrojmë, bota çka lexon e beson. Ditët e fundit Serbia ka trilluar edhe një film të tillë (me të cilin pretendon ta paraqesë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si terroriste). Është po e njëjta Serbi, "Akademia" e së cilës për më shumë se një shekull harton elaborate nga Çubrilloviqët, Garashaninët, Andriqët, Rankoviqët, Millosheviqët... as këta të sotëm nuk ndryshojnë aspak), shfarosëse për zhdukjen e shqiptarëve, (dhe duke e përdorur rrenën si "argument dhe prioritet", në mungesë identiteti, ajo ka mbijetuar. Fatkeqësisht avazin e vjetër e vazhdon edhe sot, (patogjinë dhe potolerueshmërinë ndaj shqiptarëve). Serbia jo që nuk ka kërkuar falje publike për krimet, gjenocidin dhe etnocidin në Kosovë (siç ka bërë dikur kancelari gjerman Vili Brand në Varshavë të Polonisë në vitin 1970, Vuçiçi nuk e ka kurajën e Brandit që të përkulet i turpëruar në Prishtinë dhe të kërkojë falje, sepse falja do ta nënkuptonte pranimin e fajësisë, por vazhdon në mënyrë të paskrupullt ta luajë lojën e "viktimës".

Ne çuditërisht vazhdojmë me

kompleksin e inferioritetit, thuajse asgjë nuk po ndodh!

Me gjithë këto argumente në duar (dhe shumë të tjera që është dashur t'i hulumtojmë e t'i gjejmë e se kemi bërë), nuk kemi qenë dhe nuk jemi as sot gjithaq vigjilentë dhe të përgjegjshëm e nuk kemi ditur as t'i ruajmë e as t'i plasojmë në botë.

Përgjegjësia është e përbashkët, kolektive.

Shteti dhe institucionet e Republikës së Kosovës janë treguar duarshtrenguar dhe koprrace për përkrahjen financiare, stimulimin dhe motivimin e autorëve të këtyre veprave, (disa prej të cilëve kanë punuar që dy dekada për t'i shkruar ato vepra, kanë shitur edhe pronat e tyre private), në vend se t'i sponsoronte veprat e tilla dhe t'i kurajonte autorët për hulumtime dhe vepra të reja dhe t'u jepte mbështetje veprave të tyre. Në një shtet funksional këtyre veprave do të duhej dhënë prioritet mbi prioritetet, (ndërkohë që nga institucionet e Kosovës në jo pak raste përkrahen "projekte koti" pa ndonjë vlerë të çmuar, të cilat edhe ndikojnë drejtpërdrejt në shkulturizimin e shoqërisë). Apo nga këto vepra në të cilat shkruhet për luftën, dikush nga përfaqësuesit e institucioneve mund të mos ketë fituar ndonjë shumë të majme financiare?

Pa faj në këtë drejtim nuk janë as mediat, sidomos ato elektronike, shumica prej të cilave kanë mbushur TV e tyre me seriale (dikur latino-amerikane, tani turke, dhe kanë kontaminuar në sasi të ndjeshme hapësirat mediale ku gjithçka tjetër mund të gjesh veç edukatës e kulturës, duke ua shpërlarë kështu trurin qytetarëve të pafajshëm).

Botimin e veprave e tilla, që dokumentojnë gjenocidin serb

në Kosovë, do të duhej ta merrnin përsipër institucionet e arsimit dhe të kulturës e t'i shtypnin në mijëra kopje, t'i përkthenin, t'i shoqëronin me fotografi kolor dhe t'i shpërndanin nëpër ambasada të të gjitha shteteve, jo vetëm në Kosovë. Kushtueshmëria e tyre financiare ndoshta mund të duket shumë e lartë, por mos të harrojmë se çmimi i mosbotimit dhe i neglizhimit "me ose pa qëllim e dashje", të tyre do të jetë i shumëfishtë për gjeneratat e ardhshme. Kjo indiferencë, neglizhencë dhe kjo harresë e "trashë" nuk justifikohet me asgjë, ama bash me asgjë.

Athua mund të falet sjellja juaj me aq komoditet ndaj diçkaje të ndodhur dhe të vërtetë, e cila është shumë e rëndësishme dhe e dobishme, është esenciale. Do të thosha, është kapitale të nxirret në dritë.

Kurdoherë dikush duhet dhënë përgjegjësi dhe llogari.

Po ATA Heronj e ATO Heroina që punuan e luftuan ndër shekuj për t'i thyer zinxhirët e prangat e robërisë edhe atëherë kur nuk dukej dritë në tunel, ATA dhe ATO që besuan në vete dhe në LIRI, sakrifikuan gjithçka për pavarësinë dhe lirinë tonë, athua si ndihen atje në amshim tekta ne i harruam që me lulen e parë mbi varr, dhe i përmendim heraherës nëpër përvjetorë pompozë derisa ua kemi mbuluar gjakun me harresë?

Po ato vajza të mitura dhe ato gra të pafajshme që u çnjerëzuan, u dhunuan e u copëtuan bajonetash nga barbarët serbë nëpër shtëpitë e tyre, në emër të kujt "dorëzuan" nderin, trupin e shpirtin dhe mbetën përjetësisht "as gjallë as dekë"?

Po ato foshnja që, që në embrion sapo kishin dëgjuar të rrahurat e para të zemrës, e që prindërit ende nuk ua kishin vënë emrat, e që u therën me thika e bajoneta nga barbarët historikë serbë, veç pse ishin shqiptarë?

Po gjyshërit e prindërit tanë që në moshë të thyer u shkulën dhe u shpërngulën dhunshëm nga shtëpitë dhe trojet stërgjyshore, me torturat dhe mizoritë barbare serbe, ndërsa ata që nuk pranuan t'i lëshonin pragjet e shtëpive të tyre, u torturuan në mënyrat më çnjerëzore, u masakruan, u dogjën e u poqën të gjallë, e u hodhën puseve e lumenjve për t'i humbur gjurmët e krimeve ndaj tyre.

Po ata të rinj shqiptarë civilë e të pafajshëm që u grabitën nëpër familjet dhe shtëpitë e tyre, nga policia dhe ushtria serbe, e që po quhen (të zhdukur, ata nuk janë të zhdukur), dhe trupat e tyre u bartën në mënyrë të organizuar nga ushtria serbe, u mbytën me tortura çnjerëzore, u dogjën nëpër furnalta të minierave, e me hirin e tyre Serbia shtroi rrugët, të tjerët u mbytën nëpër frigoriferë dhe u hodhën

lumenjve, shumë të tjerë u varrosën në varreza masive e disa të tjerëve kafkat ua bënë llambadarë?

Po ata djem nënash shqiptarë që u nxorën me dhunë nga kolonat dhe u plaçkitën e u pushkatuan pa gjyq, para prindërve?

Po ato vajza e djem shqiptarë që nga përndjekjet sistematike të regjimit totalitar serb nuk arritën të martohen e të krijojnë familje, as të riprodhojnë as veten e lëre më ta shtojnë Kombin, me çka humbi sasi e madhe e energjisë së Kombit shqiptar?

E sa e sa shqiptarë të palindur...

Përbuzja e LIRISË!

Ato GRA e ATA burra që humbën familjet dhe gjithçka patën e nga dhimbja e mërzia, të mbetur vetëm, ranë në depresion e përfunduan spitaleve dhe çmendinave?

Po ATA e ATO ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) (që, sipas statistikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të vitit 2010, (tani nuk e di sa është)), 49 ushtarë të UÇK-së, të harruar nga shokët e ditëve të vështira të luftës, të cilët "humbën" pas luksit të tepruar dhe posteve politike, "humbën" pas materialeve, u pasuruan në krahë të luftës dhe u shkëputën lehtë nga idealet e dikurshme dhe e kaluara e lavdishme, tjesht u "dehën" nga liria dhe e përbuzën LIRINË. (Mos harroni, HISTORIA është punë e madhe. Ajo nuk fal). Po jua kujtoj, sa për ilustrim, një postulat të Hasan Prishtinës: "DHE PARA SË GJITHASH, RUHUNI NGA MALLKIMI I HISTORISË, DHE MOS E HARRONI ATË KUR TA JEPNI MENDIMIN TUAJ".

Luftëtarët, të harruar, neglizhuar, injoruar, të indinjuar e poshtëruar edhe nga institucionet e Republikës së Kosovës, për të cilat kishin luftuar, ATA dhe ATO ia bënë gjyqin vetes?

Po ATA shqiptarë e shqiptarë (afër një milion) që dhunshëm nga policia dhe ushtria e Serbisë u përzonë nga shtëpitë dhe pronat e tyre dhe u detyruan të ecin me këmbë në kolona, disa edhe me trena u deportuan në vendet fqinje Shqipëri e në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi e prej andej shumica shkuan në vende të treta, shumica s'u kthyen më, u tretën rrugëve të botës.

Po ATA mërgimtarë shqiptarë me djersën dhe mundin e të cilëve u ble armatimi dhe ushqimi i luftës dhe u mbajt e gjithë logjistika përcjellëse, shumë prej të cilëve erdhën kur i thirri gjaku?

Gjitha këto sakrificat mbinjerëzore, dhe "modele" vdekjesh padyshim që u bënë në emër të lirisë dhe të njerëzores dhe, si duket, nuk na ndërgjegjësuam si shoqëri?


Si vend i paradokseve që jemi, për mua personalisht ky është



më i rëndi. Athua edhe çka duhet të ndodhë me ne që të na ndërgjegjësojë e vetëdijesojë për ta mbrojtur ushtarin dhe ushtrinë tonë, me çka do ta mbrojmë lirinë tonë kolektive? Po si mbrohet liria? Duke harruar gjithçka u dha për të? Duke e mbuluar kujtesën me kurora lulesh? Duke u turpëruar nga temat "demode" dhe librat e luftës? Duke u turpëruar për t'i treguar dhunimet? Duke u "mburrur" dhe "krenuar" me "asgjëtë" tona për luftën? Duke abstenuar nga e vërteta? Duke ua lënë brezave të ardhshëm, me dashje e qëllim, përsëritjen e historisë...? Duke u mburrur që harrojmë? Kështu, ja e mbulojmë diellin e lirisë! Lufta dhe liria mbrohen me ligj! Institucionet e Republikës së Kosovës (në këtë rast Kuvendi i Kosovës), si dhe subjektet politike përfaqësuese të të gjitha mandateve qeverisëse të pasluftës, edhe pas 21 vjetësh të përfundimit të luftës, pavarësisht "përpjekjeve", (qofshin këto edhe të ditëve të fundit), ende nuk arritën pajtueshmëri dhe unitet për miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lufta e drejtë dhe e pastër

Paradoks se jo mahi! Ushtria Çlirimtare e Kosovës është kryevlera e djeshme, e sotme, e nesërme, e përhershme dhe e përjetshme e kombit shqiptar. Ajo ka në ballë vulën e gjakut të këtij populli të shumëvuajtur e të stërmunduar, që do t'i shëmbëllej sa të ketë shqiptarë mbi dhe dhe e cila ka luftuar në emër të humanizmit dhe vlerës universale të lirisë, për ta mbrojtur popullin shqiptar të Kosovës nga kanosja e rrezikut të shfarosjes nga regjimi totalitar, hegjemonist e fashist i Serbisë. Mosdenoncimi i Serbisë nga institucionet e Kosovës, për gjenocidin dhe krimet monstruoze serbe mbi popullin e pambrojtur shqiptar të Kosovës, mosndëshkimi i saj që 21 vjet... solli ndërrimin e roleve mes agresorit serb dhe viktimës shqiptare. E kujt pra ishte lufta, e kujt është liria, e kujt harresa, e kujt kujtesa, e kujt historia, e kujt (pa)përgjegjësia? Për krimet e Serbisë në Kosovë kanë shkruar këta autorë, (të më falin ata për të cilët nuk e di): Nusret Pllana, (Nusret Pllana dhe Hanëmshahe Ilazi janë bashkautorë të librit për vrasjen e fëmijëve në Kosovë), Afrim Mustafa, Habib Zogaj, Dan Ibrahim, Ahmet Qeriqi, Bardhyl Mahmuti, Fetnete Ramosaj, (ish-

sonë historike kolektive, për ne dhe për brezat e ardhshëm, t'ju ndihmojmë edhe ne si qytetarë, (në mungesë të përkrahjes institucionale, punë e tyre duhej të ishte), të vetëfinancohen dhe të arrijnë të plasojnë dhe t'i publikojnë faktet autentike dhe argumentet e tyre për krimet serbe në Kosovë, të grumbulluara që njëzet vjet, dhe të njëjtat të mund t'i shohë e gjithë bota në "You Tube" "Yjet që nuk vdesin". Përderisa luftëtarët e lirisë kanë luftuar të etur e të uritur, kanë kaluar kufijtë duke bartur në supe armatimin dhe municionin e luftës (duke bartur mbi supe lirinë), kanë lënë gjymtyrët betejave dhe kanë falur edhe më të shtrenjtën që falet, jetën pra, atëherë pse ne të mos u ndihmojmë bashkëluftëtarëve të luftës së djeshme dhe "luftës" së sotme për t'i mbrojtur vlerat e luftës nga shtëpitë tona, pa u lodhur fare. Po fundja, kush jemi ne (të gjithë pa përjashtim), (ky është luks i tepruar), që po tregohemi kaq indiferentë e injorantë, shpërfillës, neglizhentë e harrestarë ndaj kujtesës dhe historisë sonë të vjetër dhe të re? Së paku të tregohemi më humanë e më njerëzor ndaj atyre, ndaj atyre që u flijuan, ndaj gjakut e lotëve tanë, ndaj vetvetes, kombit tonë të lashtë e liridashës, ndaj kujtimeve tona për ta dhe, në vend se t'i harrojmë, të përpiqemi, ama seriozisht, në çdo mënyrë të mundshme ta çmojmë, ta vlerësojmë, nderojmë e lartësojmë gjakun dhe veprën e tyre. Duke vepruar sot, lehtësojmë sadopak vuajtjet e popullit tonë. Nuk mjafton krenaria. Krenaria, duke mos e ruajtur veprën e tyre, është krekosje e kotë dhe e humbet kuptimin. Na duhet ndërgjegjësim individual, kolektiv e institucional, këmbëngulje dhe vetëmohim t'i dalim në mbrojtje vetvetes, të vërtetës sonë të gjakosur, kujtesës sonë që armiqtë tanë shekullorë bashkë me "miqtë e rrejshëm" po përpiqen të na e mohojnë. Kjo është punë e lehtë por, paraprakisht, duhet të duash ta bësh, duhet ta duash ushtrinë tonë, dhe kjo përpjekje e jona kaq e vogël sot tregon nivelin tonë të pjekurisë, maturimit, kulturën tonë jo vetëm politike, ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin tonë si popull e komb dhe seriozitetin tonë për ruajtjen dhe arkivimin e kujtesës sonë historike kolektive. Arkivin e UÇK-së, Muzeun e Krimeve Serbe, Muzeun e Kujtesës, Muzeun e Zhbërjes dhe Holokaustit që ndodhi në fundshekullin e XX-të (1998/99), ne do të duhej t'i kishim qysh pas mbarimit të luftës (tash jemi 21 vjet pas luftës e pa to). Kah po shkojmë? Një thënie e njohur amerikane thotë: Nëse nuk ka emra, njerëz, dëshmitarë, data, fotografi, vende, dëshmi... nuk ka ndodhur. Vitet po shkojnë e ne po vendnumërojmë. Kush do duhej t'i themelonte



çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1998/99) ka qenë e pashmangshme, e pabarabartë, e paevitueshme dhe e domosdoshme. Pa luftë nuk do të vinte kurrë liria. Vetëm atëherë kur ne si popull u vetëdijesuam, u mobilizuam, e shtrënguam armët në brez, dhe e bindëm veten dhe botën se e kemi seriozisht luftën për liri e pavarësi, atëherë reagoi bota demokratike, aleanca më e madhe ushtarake në botë, NATO, dhe në emër të humanizmit përkrahu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-në), si dhe të drejtën e popullit të Kosovës për liri. Në mungesë të atij ligji u jepet mundësia dhe "liria" cilitdo njeriu të lig e të pavetëdijshëm që në çfarëdo mënyre ta fyejë, shajë e njollosë luftën e shenjtë dhe të shtrenjtë të UÇK-së, që me gjak e kemi paguar.

luftëtare e UÇK-së, e cila ka bërë aq shumë hulumtime të krimeve serbe të cilat edhe i ka publikuar në veprat e saj dhe që, fatkeqësisht, bëri aq sa mundi dhe sa ishte gjallë nuk u trajtua dinjitetshëm nga institucionet e Kosovës, ndërroi jetë në kushte të vështira dhe u varros me pompozitet), Dibran Fylli, Ukë Thaçi etj., ndërsa Esat Shala ka ruajtur shumë dokumente, fotografi, video-incizime (pothuajse një arkiv të tërë dhe, paradoksalisht, është i papunë). Grup autorësh poetë kanë botuar librin me poezi "Dritë mbi plagë". Të gjithë këta autorë që kanë shkruar për gjenocidin dhe krimet serbe për mua janë institucione në vete, (natyrisht unë e përfaqësoj vetëm veten). Andaj, mendoj se është e udhës që përderisa këta autorë me shkrimet dhe publikimet e tyre kanë ruajtur një pjesë të kujtesës

këta muze? Natyrisht që shteti. Por shteti jemi edhe ne, secili nga pak jemi shtet, sepse secili prej nesh duhet ta kishim dhënë ndonjë kontribut sado të vogël në këtë drejtim duke u treguar të zellshëm e vigjilentë për ruajtjen e shenjave të luftës, duke salduar kujtesën njëherë e mirë në trurin tonë si vlerë dhe si kulturë. Ushtria është atribut i shtetit, andaj ta mbrojmë sot atë që nesër, në rast nevojë, na mbron neve. Meqenëse shteti ynë, Kosova, është ende i brishtë dhe me apo pa qëllim e vetëdije ndërgjegjësuere institucionale nuk e ka trajtuar me seriozitetin e duhur këtë problematikë për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen, arkivimin dhe plasimin e publikimin e krimeve serbe në Kosovë, ne bashkërisht si qytetarë mund ta ndihmojmë shtetin tonë në këtë drejtim. Ne jemi qytetarët e Kosovës dhe Kosova është shteti ynë. Duke komunikuar, bashkëbiseduar dhe ndihmuar njëri-tjetrin në mbrojtje të këtyre vlerave kapitale të shtetit, të ushtrisë sonë, ne e ndihmojmë veten, rininë e shoqërinë tonë. T'i përkrahim vëllezërit e motrat tona që shkruan për vlerat e luftës dhe krimet serbe, këta njerëz atdhetarë e të mençur e vizionarë, dhe t'u jemi mirënjohës që u kujdesën për kujtesën tonë kur ne ishim në gjumë. Në këtë mënyrë historia (që, fatkeqësisht, pak e shkruamë vetë) dhe historiografia jonë të mos jenë të ndryshme dhe të mos na përsëriten. Ju jam fort mirënjohës: Nusret Pllana, Esat Shala, Afrim Mustafa, Ahmet Qeriqi, Hanëmshahe Ilazi, Fetnete Ramosaj, Bardhyl Mahmuti, Dan Ibrahim, Nuh Bytyqi, Ramize Murtezi-Shala, Ukë Thaçi, Dibran Fylli, Çerçiz

Loloçi (të cilit i kërkoj falje sepse vonë e mora informatën), dhe të gjithë ju poetë e poetesha që keni shkruar poezi për gjenocidin serb në Kosovë. Kërkohe aq pak nga ne, prandaj ju lutem bëjeni sot (SUBSCRIBE) "YJET QË NUK VDESIN", në platformën YOU TUBE. Unë ndiej përgjegjësi. Po ti? Si qytetare e Kosovës që ndiej përgjegjësi, ju lutem ndërgjegjësohuni ju lutem institucionalistë që na përfaqësoni. Në fund po i jap dy propozime që shpresoj të mos bien në vesh të shurdhër. 1. Propozoj që autorët e këtyre librave dhe fakteve të tjera të lartcekura të jenë pjesë e institucioneve muzeale që mund dhe duhet të themelohen në vazhdim për ruajtjen dhe arkivimin e këtyre dëshmimeve, fakteve e argumenteve. 2. Propozoj që cilido qoftë delegacioni i Kosovës në bisedimet e pretenduara me Serbinë, t'i marrë me vete këta libra përmes të cilëve arrihet përfaqësimi dinjitoz dhe serioz i gjithë golgotës shqiptare nga regjimi i Serbisë. Ju lutem lini inatet dhe mendjemadhësinë, lini ambiciet personale dhe xhelozitë, këtu në këtë kauzë është Kosova me të gjithë luftëtarët, martirët, viktimat, të burgosurit, të dënuarit, të persekutuarit, me varret pa kufoma e kufomat pa varre e pa emra. Janë kujtimet, shtëpitë, fotografitë, ëndrrat e dëshirat e tyre dhe tonat, zërat dhe ëndrrat e fëmijëve që tani veç në ëndrra mund t'i shohim. Të mos harrojmë, secili kemi nën sqetull amanetin e heronjve. Është një lutje njerëzore, para së gjithash. Bashkë do t'ia dalim ta harrojmë harresën!

29.07.2020


Familja Kryeziu në Cyrih hap të pame për afaristin Latif Kryeziu

(Epoka e re)

PRISHTINË, 2 GUSHT - Familja e ngushtë e afaristit të ndjerë Latif Kryeziu, me punë dhe banim në Zvicër, ka hapur sot të pame në Cyrih të Zvicrës. Njoftimin për hapjen e të pamës për të e ka dhënë familjari i tij i ngushtë, afaristi Kastriot Kryeziu, në llogarinë e vet në "Facebook", i cili për "Epokën e re" ka thënë se "vdekja e parakohshme dhe e papritur e bacit Latif na ka pikëlluar shumë sepse ne familja Kryeziu kemi humbur njeriun më të dashur e më të pashoq që kishim. Megjithatë, dhembjen dhe pikëllimin, kujtimet e mira dhe fjalët dhe punët e tij të mira, kemi vendosur t'i ndajmë me miq, me shokë dhe me dashamirë të tij dhe tanët, të cilët na janë gjetur pranë në këto ditë dhembje fizike dhe shpirtërore". Po ashtu, Kastriot Kryeziu ka njoftuar se "e pamja për Latif Kryeziun është hapur sot, më 2

telegram ngushëllimi familjes së tij i kanë dërguar krerë të shtetit të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë etj. Presidenti Hashim Thaçi, me rastin e ndarjes nga jeta të Kryeziut, pas vajtjes për ngushëllime dhe pas dhënies së medaljes "Urdhri i Pavarësisë", ka thënë: "Isha për ngushëllime në familjen Kryeziu për ta ndarë dhimbjen së bashku, pas vdekjes së biznesmenit Latif Kryeziu, mikut tim për më tepër se dy dekada. Për kontributin e tij në procesin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, pas vdekjes, për z. Kryeziu ndava Urdhrin e Pavarësisë".

Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka veçuar kontributin e Latif Kryeziut dhënë në kohë të luftës dhe të paqes. Veseli i ka shprehur ngushëllime të sinqerta familjes së tij: "Me pikëllim mora lajmin për vdekjen e mikut tim Latif Kryeziu, sipërmarrësit të suksesshëm që krijoi mijëra vende pune dhe atd-



gusht, ditë e diel, nga ora 09:00 deri 16:00, në Zürich, adresa: Lochackerstrasse 6, 8424 Embrach, në restorant "Rozafa".

Ngushëllimet e krerëve të shtetit e të partive politike, të miqve të Latif Kryeziut

Me rastin e vdekjes së Kryeziut,

hetarit të madh që dha mbështetjen meritore për kauzën tonë kombëtare. Vdekja e hershme e tij është një humbje e madhe për Kosovën. Latif Kryeziu arriti ta vendosë vendin tonë në hartën e bizneseve ndërkombëtare dhe kompanive multinacionale, duke sjellë tek ne brendin e mirënjohur "Shell". Ngushëllime të sinqerta familjes, miqve dhe bashkëpunë-

torëve të tij! Ta kujtojmë përherë për veprat e mira që la pas!" Po ashtu, ngushëllime familjes Kryeziu i ka shprehur edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj: "I pikëlluar nga lajmi për ndarjen nga jeta të Latif Kryeziut, shpreh ngushëllimet e mia për familjen dhe të gjithë ata që njohën. Latifin do e kujtojmë gjithmonë

për kontributin e tij në përpjekjet për liri dhe për ndërtimin e ekonomisë së vendit. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!" Ngushëllime familjes Kryeziu i ka shprehur edhe një nga afaristët e mëdhenj të Kosovës, presidenti i "Mabetex Group", kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli: "Një nga miqtë e mi dhe një nga sipërmarrësit më të mëdhenj të Kosovës, na paska lënë. E mbaj mend


Latifin si një njeri me zemër të madh, energjik dhe human. Veprat e tij do të shoqërohen gjithnjë me emrin e tij. Ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes Kryeziu".

"Urdhri i Pavarësisë" postmortem

Presidenti Hashim Thaçi ditë më parë ka pritur në takim familjarët e të ndjerit Latif Kryeziu, të cilin e ka dekoruar me medaljen "Urdhri i Pavarësisë" (postmortem), dekoratë kjo që u jepet personave të cilët kanë dhënë kontribut të lartë për "Pavarësinë e Kosovës". "Dhe i tillë ishte edhe z. Latif Kryeziu, i cili nuk ishte vetëm një afarist i suksesshëm, por edhe një patriot i vërtetë i cili i kontribuoi luftës dhe ekonomisë së vendit", është thënë në njoftimin e Presidencës së Republikës së Kosovës.



Përsiatjet për lashtësinë - përsiatje për të sotmen



REXHEP QOSJA

Prej se e njoh si shkrimtar dhe publicist nuk më ka shkuar mendja se Reshat Sahitaj shkruan edhe poezi. Se është edhe poet ai, besoj nuk u ka shkuar mendja as lexuesve të tij të tjerë. Por, ja, proza poetike me titullin e jashtëzakonshëm "Rojtari i pjesëve të harruara" edhe mua, edhe, besoj, lexuesve të tij të tjerë, na dëshmoi se Reshat Sahitaj është edhe poet, poet i cili poezinë e shkruan më rrallë, por jo me më pak dhunti krijuese sesa prozën. Proza poetike e Reshat Sahitaj, "Rojtari i pjesëve të harruara", më ka nxitur që këtë lloj letrar, të quajtur prozë poetike, ta shikoj pak në krahasim me llojet e tjera letrare.

Është mendim i lexuesve dhe është mendim i studiuesve të letërsisë se proza poetike është një lloj letrar, ku më pak e ku më shumë i rrallë, në letërsinë e të gjithë popujve. Për pakësinë e saj në krahasim me llojet e tjera letrare, prandaj, ankohen edhe studiuesit e letërsive të mëdha evropiane: edhe studiuesit e letërsisë franceze, angleze, gjermane, italiane, ruse, spanjolle. E të tjerë.

Proza poetike, të cilën me shumë dije dhe sukses e ka trajtuar studiuesja dhe poetesha jonë e talentuar, Donika Dabishevc, në tezën e saj të doktoratës me titullin "Proza e poetizuar", mungon pothuaj plotësisht në letërsinë tonë të vjetër; është e rrallë në letërsinë e Rilindjes Kombëtare; më e dukshme se në letërsinë e Rilindjes Kombëtare është në letërsinë mes dy luftërave botërore, në mënyrë të veçantë në letërsinë e quajtur sociale; jo më e shpeshtë se në letërsinë sociale është në letërsinë tonë bashkëkohore.

Arsyet pse proza poetike në letërsi në përgjithësi është më e rrallë, më e paktë se sa llojet e tjera letrare janë të ndryshme. Dhe ato mund të quhen arsye formale dhe arsye kuptimore gjithnjë të kushtëzuara prej vetë llojit të saj. Për të krijuar prozë poetike më të gjatë a më të shkurtër, qoftë me vlerë më të madhe, qoftë me vlerë më modeste letrare artistike, duhet dhunti e dyfishtë: dhunti për poezi dhe dhunti për prozë. Megjithatë ka prozatorë në krijimtarinë e të cilëve vërehet qartë edhe dhuntia poetike, dhuntia për të krijuar proza poetike nuk është dhuratë shumë e shpeshtë natyrore.

Proza poetike sipas të gjitha gjasave është e rrallë në krahasim me llojet e tjera letrare edhe për arsye se në të kërkohet një dendësi e jashtëzakonshme kuptimore. Ajo është lloj letrar në të cilin me pak fjalë duhet të thuhet shumë, shumë. Dhe më tej, ajo është lloj letrar në të cilin përpos figurshmërisë së pjesëve – fjalive e vargjeve, është e kërkuar edhe figurshmëria e tërësisë.


Proza poetike, proza e parë dhe deri sot e vetme poetike e Reshat Sahitaj, "Rojtari i pjesëve të harruara", dëshmon se ai i ka të dy këto dhunti: dhuntinë për të shkruar prozë dhe dhuntinë për të shkruar poezi; dhuntinë për të shkruar me dendësi kuptimore dhe dhuntinë për të shkruar me figurshmëri të pjesëve dhe me figurshmëri të tërësisë. Në qoftë se dhuntinë për të shkruar në prozë e ka dëshmuar me romanet e tij, disa prej të cilëve janë të përkthyer në gjuhë të huaja, kryesisht në gjuhën franceze, dhuntinë për të shkruar poezi po e dëshmon për herë të parë me këtë prozë poetike. Proza poetike "Rojtari i pjesëve të harruara" është përsiatje jashtëzakonisht e stisur për historinë shqiptare prej kohës së lashtë ilire e deri sot. Dhe, kjo përsiatje sendërtohet përmes krahasimit të figurshëm kuptimor të të sotmes, shqiptare, me lashtësinë, ilire.

Proza poetike "Rojtari i pjesëve të harruara" ka një personazh të pa emër e mbiemër, i cili me fatin e vet dhe me mendimet e veta e përmbledh poetikisht atë histori. Ai është i dënuar prej fatit të kobshëm që të jetë rojtar eshtrash! I ulur në kafkën e skeletit, që dikur kishte qenë mbret i paraardhësve të tij të lashtë, ai i kujton fushat, malet, ujërat, në përgjithësi bukuritë natyrore të vendit të vet ku kishin jetuar ata paraardhës; mandej e kujton historinë e tyre ashtu siç e kishte imagjinuar poeti i madh i Greqisë së lashtë, Homeri: mandej si e kishte parë dhe paraqitur Virgjili në Eneidën e tij; mandej si e kishte parë dhe paraqitur historiani romak Kurt Rufi; mandej si e kishte parë dhe paraqitur historiani i madh romak, Tit Livi, i cili tregon se si mbreti i tij, në kafkën e të cilit ishte ulur, e kishte mbytur të vëllanë vetëm e vetëm për t'ia marrë të fejuarën. Dikur rojtari i pjesëve të harruara e hudh veprën e Tit Livit mes eshtrave të cilët dëshiron t'i djegë, por, ato janë eshtra që "nuk i shkatërron kurrfarë zjarri!"

I dëshpëruar pse ishte rojtar eshtrash, ai do t'i lutet Perëndisë, që t'ia marrë jetën. Por, lutja e tij mbetet e kotë dhe mbetet e kotë sepse kërthizën e kishte prej hirit, kurrizin prej zinkut të Dardanisë, kurse frymën prej lagështirës së Dukagjinit! Dhe, do të jetë i dënuar

për të ruajtur eshtrat me dorën e tij të cinguar gjithnjë të përgjakur në të cilën do të ushqehen mizat, derisa të mos gjenden copat e flamurit, copat e flamurit që simbolizon copëtimet e trojeve etnike!

Kur i del kllapia dhe vjen në vete ai e fillon vallen e luajtur në dasmën e mbretit Agron dhe e fillon përfundit tavanit ku vareshin gërshetat e pluhurosura të Teutës! Duke mos dashur të vallëzojë i vetëm, e fton rojtarin e thesarit, që kishte vdekur para katër muajsh, që t'i bashkohet në valle. Por...por, i lodhur prej numërimit shekullor të florinjve, ai nuk pranon që t'i bashkohet! I



pezmatuar nga sjellja e rojtarit të thesarit, ai ngjesh shpatën, i hip atit dhe i bërtet atij:

-Unë jam paraardhësi yt e ti as emrin s'ma di!

E ngrit shpatën lart!

I djersitur pamatshëm e pret kufomën që nuk e njihte!

Dhe, shkon të bëjë roje në copën më të harruar të Atdheut!

Siç shihet, florinjte e rojtarit të thesarit e shtojnë kobin e rojtarit të njerëzve të vdekur para mijëra vjetësh!

Florinjte atëherë – në lashtësinë ilire dhe florinjte tani në përtashësinë tonë! Mos është ky kobi që e shënon lashtësinë dhe kobi që e shënon përtashësinë e atyre eshtrat e të cilëve i ruan rojtari i prozës poetike të Reshat Sahitaj? Të ishin vetëm etjet për thesarë të rojtarit të tyre shkaku i fatkeqësive historike, iliro-shqiptarët ndoshta do të bëheshin më lehtë e më shpejtë subjekt i historisë së tyre. Por rojtarët e thesarit nuk ishin kryesorët, jo: ata ishin të sunduar e të urdhëruar prej atyre, që atëherë quheshin mbretër, kurse sot rojtarët e thesarit sundohen e urdhërohen prej atyre që nuk quhen mbretër, por sundojnë e urdhërojnë si mbretër! Nën sundime të tilla, pasardhësit e rojtarëve të eshtrave, besnikë të detyruar ndaj rojtarëve të thesarit dhe mbretërve të tyre, detyrohen të shkojnë e të ruajnë pjesë të harruara, prej të tjerëve të pushtuara, të Atdheut.

ROJTARI I PJESËVE TË HARRUARA

Reshat SAHITAJ

Rojtari plak u mërzi duke ruajtur njerëzit, që kishin vdekur para mijëra vjetësh. Pështyu në tokë dhe u ra skeleteve që e rrethonin. U ulë mbi kafkën e skeletit, që dikur kish qenë mbret i tij, e jehona e emrit në fillim të shekullit njëzet i tingëllonte: Agron. Nga xhepi nxori shkrepën, që ia solli i vdekuri para katër muajve. Ndezi cigaren e shuar dhjetë ditë më parë. Mbështeti duart për faqe Mendoi për të kaluarën e largët. Iu kujtuan: fushat, malet dhe ujërat e kulluar, të cilat Homeri i verbër i përshkroi pak ditë para vdekjes. Iu sollën ndërmend tokat pjellore, të cilat i madh e i vogël në Romë u kish lakmi. Iu kujtua Eneu mizor, kur një ditë vjeshte vizitoi Therandën. Në çatinë e kalasë, e përshëndeti me dorën e cinguar, e pastaj, dy ditë e dy net, biseduan për shumë gjëra. Ah, Virgjili dinak! Me ç'hollësi e përshkroi këtë takim, edhe pse kurrë nuk e kish parë as kalanë as Therandën. Fiku cigaren e zverdhur nga pështyma dhe iu lut Perëndisë në një gjuhë, të cilën pasardhësit e flasin me gabime. Pas dy orë lutjesh, ofshau. Ndërkohë, iu kujtua mbreti, kafkën e të cilit e kishte para këmbëve, mbreti të cilin Kurt Rufi e quante "mbret qymyrxhi", ndërsa një historian tjetër e përshkruante kalorës nëntëdhjetëvjeçar, i cili deri në frymën e fundit, ëndërronte pushtimet. Nga malli për kohërat e kaluara, iu dridhen shpatullat. Sa të freskëta i dukeshin ditët, kur Jul Qesari pinte verë në pellgjet e Drinit të Zi, që sot skamnorët e quajnë Shën Naum. Por, vaj, shkëlqesisë romake nuk i pëlqente treva bujare aq sa e dehte vera e bardhë. I largoi ca eshtra të mykur dhe nxori veprën e Tit Livit. Me mëngën e gunës fshiu faqet e librit të pluhurosur. Me pikëllim i lexoi vargjet, se si mbreti i tij kish mbytur vëllain e vet për t'ia rrëmbyer të fejuarën. Ç'i duhej leximi? Ngjarjen e dinte shumë më mirë se autori, ngase e kishte parë me sytë e vet. Hodhi librin mes eshtrave. U ngrit. Eci si i çmendur nëpër dhomë. Dëshiroi t'i djegë të gjithë eshtrat, por më kot. Ato nuk i shkatërronte kurrfarë zjarri. Ngriti duart mbi kokë dhe përseri iu lut Perëndisë që t'ia merrte jetën. Nuk dëshironte më të jetë rojtar i të vdekurve. Njëzet e tre shekuj iu dukën të gjatë. Nga lart, zëri i thellë i Perëndisë i urdhëroi: "Kërthiza jote është prej hiri, por kurrizin ta godita prej zinku të Dardanisë! Fryma jote buron prej lagështisë së Dukagjinit, prandaj do të jesh rojtar eshtrash derisa të gjenden copat e flamurit. Huuu! Do të jesh rojtar eshtrash! Huuu, vepra ime më e përsosur! Huuu, dështimi im shekullor! Tehu që ta cungoi dorën ende është me gjak të freskët, kurse mizat që ushqehen me të, ta kanë fëlliqur ardhmërinë. Ti je roje e përjetshme! Roje eshtrash! Eshtrash, huuuu! Kur i doli kllapia disaorëshe, filloi vallen më të vjetër që e kish luajtur në dasmën e mbretit Agron. Këmbën e djathtë gjysmë hapi përpara. Majat e gishtërinjve i preknin vetëm pak në tokë. Me një ritëm të ngadalshëm lëvizti duart. Në kup vallëzimi, dy herë kërceu dhe preku tavanin e qelbur, ku vareshin gërshetat e Teutës plot pluhur. Thirri rojtarin e thesarit, që kish vdekur para katër muajsh, t'i bashkohej në valle. Por, i vdekuri ndihej i lodhur nga numërimi shekullor i florinjve. Rojtari plak pushoi së vallëzuar. E shaloi atin, ngjeshi shpatën dhe thirri me tërë zërin: "Unë jam paraardhësi yt, para të cilit, dikur sunduesit e Mesdheut përkuleshin si cullë para meje, e bitha jote as emrin s'ma di! E ngriti shpatën lartë, U djersitë nën sjetull dhe e preu dysh kufomën që nuk e njihte. Hipi mbi kalë Shkoi të bënte roje në copën më të harruar të Atdheut.

E rrallë

Universi "ndryshon" moshë

Universi është pak më i ri në moshë nga çmendohej deri më sot ose, më saktë, një miliard vjet më i ri dhe duke u bazuar në kalkulimet e fundit të lëvizjeve të dhjetëra galaktikave, rezultojnë të jetë 12.5 miliardë vjeç. Deri tani metodat e përdorura për ta përllogaritur moshën e universit janë bazuar mbi konstanten e Hubble, që mat indeksin e zgjerimit të universit, por edhe mbi vërtetimet e kryera mbi ekon e Big Bang, apo radiacionin kozmik. Sipas Hubbl, kozmosi ekziston prej 12-14.7 miliardë vjetësh, ndërsa sipas radiacioneve të lëshuara nga Big Bang, moshja është 13.7 miliardë vjet. Ndërsa me metodën e re është arritur të kalkulohej pothuajse me precizion



distanca mes galaktikave, me anë të teleskopit hapësinor Spitzer të Nasës. Këto matje janë përdorur edhe për përllogaritjet e distancave të 95 galaktikave të tjera. Sipas drejtuesit të studimit James Schombert, universi qeveriset nga një sërë skemash

matematike të shprehura në ekuacione. Kjo metodë shpjegon pikërisht në mënyrë më të hollësishme lëvizjet e galaktikave dhe transformon këto të dhëna në ekuacione që më pas shërbejnë pikërisht për ta përcaktuar moshën e universit tonë.

BARSOLETA E DITËS



Mjeku: Dëshironi të vizitoheni?

Biondina: Jo, dua të abortoj.

Mjeku: Pse?

Biondina: Dyshoj që fëmija është i imi!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

Gjendet në breg një krijesë e çuditshme, askush nuk e përcakton çfarë është

Një krijesë e çuditshme e dekompozuar, prej 4.5 metrash, është parë në brigjet e Merseyside në Liverpool. Personat të cilat e kanë pikasur në rrëzë dhe e kanë fotografuar duke e postuar më pas në rrjetet sociale, nuk kanë qenë në gjendje që ta përcaktojnë se çfarë mund të ketë qenë, teksa dikush thotë se përngjanë me një kalë, e dikush

tjetër me një balenë që mund të ketë ngrënë një delfin. Edhe pse shumë komente janë lënë në këto foto të postuara në rrjet, askush nuk arriti dot që ta përcaktonte se çfarë ishte. Pas bërjes publike të këtij rasti, ekspertë të fushës mbërritën në vendngjarje për ta bërë këqyrjen dhe analizuar mbetjet por, ende nuk thanë asnjë fjalë.

FOTO E DITES



Kur s'ke pishinë, ke shatërvan! Tirana dhe shumë qytete të Shqipërisë po përballen me temperatura të larta këto ditë vere. / LSA/



DASHI

Mos u mbështetni vetëm

në mendimin e të tjerëve për të zgjedhur një çështje, por vlerësoni edhe atë se çfarë ju mendoni.



DEMI

Gjithmonë do të jeni të favorizuar

nga yjet që të bëheni një person fitues. Bëni mirë që jeni këmbëngulës sepse do të shpërbleheni në dashuri dhe në çështjet praktike.



BINJAKËT

Sot do të mbështeteni nga pikat tuaja më të

forta, por edhe në njohuritë dhe përgatitjen tuaj në çdo aktivitet që keni, qofshin ato personale apo profesionale.



GAFORRJA

Disa prej jush do të jenë të hutuar dhe

të shpërqendruar por, në përgjithësi, parashikimi i yjeve do të jetë më i mirë se parashikimi i djeshëm.



LUANI

Disa prej jush do të përballen me një

konflikt midis aftësisë për të kuptuar dhe aftësisë për të dëshiruar. Polemikët dhe rebelimi do t'ju mbajnë nën kontroll.



VIRGJËRESHA

Marrëdhëniet me të tjerët janë shpërblyese.

Partneri juaj ju pengon. Momentet plot pasion dhe dashuri nuk ju presin. Mos e kufizoni dëshirën. Dëgjoni zërin e zemrës dhe shqisave.



PESHORJA

Ju mund të përballeni me një

grindje të pashmangshme, ndoshta për shkak të një vendimi të marrë duke u bazuar në një hipotezë.



AKREPI

Asgjë nuk mund t'i ndalojë

entuziazmin, sensualitetin dhe kënaqësinë tuaj për të qenë në shoqërinë e miqve dhe partnerëve sentimentalë.



SHIGJETARI

Ju jeni gjithmonë në gjendje

të veproni me një dinakëri dhe precizion, por kohët e fundit ju po ndikoheni dhe nga ndjenjat.



BRICJAPI

Ju mund të mbështeteni te

yjet për të gjetur se kush do t'u përgjigjet instinkteve tuaja të dashurisë.



UJORI

Edhe pse nuk dëshironi, ju do të kaloni

një të diel duke bërë gjërat e zakonshme si çdo herë. Nuk do të jeni në gjendje t'i përballoni detyrat tuaja nëse i përmbaheni realitetit.



PESHQIT

Ju do të merrni shumë

iniciativa të guximshme. Do të jeni vetvetja dhe jo siç dëshirojnë të tjerët të jeni.

Morena: Më pëlqejnë mesazhet e ish të dashurve kur ata dëshirojnë një shans të dytë



Morena Tarku ka pozuar joshëse derisa ka habitur me atë se çfarë ka shkruar pranë postimit në llogarinë e vet në "Instagram". "Më pëlqejnë mesazhet e ish të dashurve të mi kur ata dëshi-

rojnë një shans të dytë", ka shkruar Morena. Modeluesja e cila kohët e fundit e ka sfiduar veten edhe si këngëtare, ka qenë emër i komentuar në media edhe për shkak të jetës private.

Charlize Theron: Jam në një marrëdhënie intime me veten



Aktorja Charlize Theron mund të jetë fituese Oskari, por ka thënë se roli që vlerëson më shumë është ai i nënës. Duke folur në një program të stilistes Diane von Furstenberg, Theron ka treguar më shumë për fëmijërinë e saj dhe babanë abuziv, ndërsa ka theksuar rëndësinë që i jep të qenit nënë për fëmijët e saj. 44-vjeçarja ka treguar se

kërkon ta japë shembullin për vajzat e saj Jackson e August. "Isha në makinë me dy vajzat. E vogla më tha diçka si 'ti ke nevojë për një të dashur'", ka thënë ajo, duke treguar se çfarë përgjigje i ka dhënë vajzës së vogël. "Unë i thashë, jo tani. Jam tashmë në një marrëdhënie, për momentin jam në një marrëdhënie me veten", ka thënë aktorja.



Rita Ora heq të gjitha për disa foto artistike në rrjete sociale

Këngëtarja e njohur shqiptare, Rita Ora, ka provokuar edhe një herë ndjekësit në "Instagram". Rita ka pozuar e zhveshur dhe imazhet artistike i ka publikuar në llogarinë e vet në


"Instagram". "Seria e diellit. Fillon tani... kush tjetër mërzitët kur bën banjën e diellit?", ka shkruar Rita. Kjo nuk është hera e parë që Rita pozon e zhveshur dhe gjithmonë rrëmben vëmendjen e ndjekësve.

Demi Rose lë pa tekst pushuesit në Ibiza me të pasmet



Demi Rose ka disa ditë që është duke shijuar pushimet në Ibiza. Ajo si shumë personazhe të njohura të shoubizit ka zgjedhur vendin përrallor, Ibizan, për pushimet verore. Brunja gjatë qëndrimit të saj në Spanjë ka ndarë me ndjekësit

postime të shumta, ku nuk kanë munguar as ato provokueset, ku modeluesja ekspozon asetet trupore. Bukuroshja me prejardhje britanike ka publikuar një foto në llogarinë e vet në "Instagram", ku shihet e shtrirë në bark teksa në fokus vë të pasmet bombastike.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli me Tovërlanin kërkon rikthimin e trofeve

Skuadra e Feronikelit ka nënshkruar kontrata të reja me trajnerin Afrim Tovërlani dhe mesfushorin Besmir Bojku. "Arsyet pse e vazhdova kontratën janë të shumta, por më të rëndësishme janë serioziteti dhe besimi të cilët ma kanë ofruar kryetari dhe zyrtarët e klubit. Pastaj kushtet e punës dhe mobilizimi për të krijuar një skuadër për titull, natyrisht se na bëjnë të ndihemi mirë dhe me angazhimin e të gjithave do të jemi aty ku dëshirojmë ne", ka thënë Afrim Tovërlani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ish-kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës në futboll, Feronikeli, është treguar skuadër aktive të dielën. Klubi nga Drenasi nuk e mbylli sezonin në mënyrën më të mirë dhe për t'i rikthyer sukseset në edicionin e ri 2020/2021 ka vendosur që skuadrës të vazhdojë t'i prijë trajneri Afrim Tovërlani.

"Toki" skuadrës nga Drenasi iu bashkua pesë muaj më parë dhe puna e korrektësia e tij bënë që kryetari Naser Ramaj t'i ofrojë kontratë të re. Sipas njoftimit të këtij klubi, kryetari Ramaj ka thënë se e vlerëson shumë trajnerin Tovërlani dhe se është i lumtur me marrëveshjen e re. Ndërsa vetë trajneri ka bërë me dije se deri te vazhdimi i bashkëpunimi me "Niklin" kanë ndikuar shumë faktorë. "Arsyet pse e vazhdova kontratën janë të shumta, por më të rëndësishme janë serioziteti dhe besimi të cilët ma kanë ofruar kryetari dhe zyrtarët e klubit. Pastaj kushtet e punës dhe mobilizimi për të krijuar një skuadër për titull, natyrisht se na bëjnë të ndihemi mirë dhe me angazhimin e të gjithave do të jemi aty ku dëshirojmë ne. Po ashtu, na bëjnë të ndihemi mirë edhe tifozët e 'Niklit' dhe të gjithë qytetarët e Drenasit të cilët në vitet e fundit janë mësuar me tituj dh Kupa", ka thënë Tovërlani për faqen zyrtare të klubit.

Skuadra e Feronikelit vazhdoi kontratën edhe për një vit me mesfushorin e dalluar Besmir Bojku. Mesfushori shqiptar nga Maqedonia e Veriut, pas paraqitjes fantastike, i bindi drejtuesit e klubit nga Drenasi për një marrëveshje të re me KF Shkëndijën edhe për sezonin e ri. "Jam i lumtur që do të



jem pjesë e Feronikelit edhe për sezonin e ardhshëm. Falënderoj presidentin, drejtorin dhe trajnerin për besimin që patën në mua. Për objektivat e klubit nuk duhet të flasësh shumë pasi dihet se Feronikeli synon majat e futbollit vendor. Na prift e mbara!", ka thënë Bojku, i cili ka gjithsej 40 paraqitje me Feronikelin dhe ka shënuar 5 gola.

Aktive edhe Ballkani dhe Llapit

Në fundjavë aktive në transferime është treguar edhe skuadra e Ballkanit, e cila ka transferuar ish-sulmuesin e Feronikelit, Mevlan Zeka dhe ish-portierin e Gjilanit, Kenan Haxhihamza. "Nënshkruam kontratën dyvjeçare me Mevlan

Zekën dhe kontratë trevjeçare me Kenan Haxhihamzën", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Klubi nga Suhareka, që dështoi të shpallet kampion në IPKO Superligë dhe triumfoi në finalen e Kupës, ka rinovuar kontratën me mbrojtësin Arbër Potoku.

Një transferim të rëndësishëm e ka bërë edhe skuadra e Llapit, e cila ka arritur marrëveshje me Ardit Peposhin, i cili luan në pozitën e mbrojtësit të majtë dhe është paraqitur në 31 ndeshje me Bylisin në edicionin 2019/20 dhe ka realizuar 2 gola e 4 asistime. "Peposhi është paraqitur me sukses në 190 ndeshje për klubet si: KF Tirana me të cilën ka fituar Kupën dhe Superkupën e Shqipërisë, pastaj KF Teuta, KF Korabi, KF Kukësi dhe, së fundmi, për FK Bylis", thuhet në njoftimin e Llapit.

SHKURT

FBK-ja: Lipjani e Feronikeli bien nga liga

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka konfirmuar rënien nga Superliga të KB Feronikelit dhe KB Lipjanit. Superliga e Kosovës në basketboll ishte vendosur të mos vazhdohet më 19 maj si pasojë e pandemisë Covid-19, ndërsa plasmani deri në atë çast u mor si final. Sipas plasmanit, Feronikeli dhe Lipjani kanë rënë nga elita. Dy klubet kanë bërë kërkesë për qëndrim në elitë. Por bordi i FBK-së, pasi ka shqyrtuar kërkesën, ka konfirmuar vendimin e marrë më 19 maj.

Januzaj, afër largimit nga Sociedadi

Edhe pse ka qenë një lojtar i rëndësishëm në sezonin e fundit duke ndihmuar Real Sociedadin ta sigurojë kualifikimin në Ligën e Evropës dhe të shkojë deri në finalen e Kupës së Mbretit. Adnan Januzaj me shumë gjasa do të largohet nga skuadra baske gjatë kësaj vere. Në fakt, Sociedadi nuk i ka ofruar rinovimin e kontratës që i skadon në verën e vitit 2022. Klauzola e Januzaj është 50 milionë euro, megjithatë ai mund të largohet edhe për 18-20 milionë euro. Në rast shitje, atëherë Sociedadi i detyrohet edhe 30 % të shumës së përfituar Manchester Unitedit, sipas marrëveshjes së arritur kur Januzaj u transferua në La Liga.

Xhaka: Me besim në vetvete dhe në këtë skuadër, mund të bësh gjithçka

Arsenali fitoi të shtunën Kupën FA për edicionin 2019/2020, pasi e mposhti në finale Chelsea (2-1). Granit Xhaka luajti gjatë gjithë takimit dhe bëri një paraqitje të mirë për Arsenalin. Ai ka thënë se ky trofe është i rëndësishëm për të gjithë klubin. "Çfarë sezoni! Me ulje dhe ngritje! Me besim në vetvete dhe në këtë skuadër mund të bësh gjithçka! Ky trofe është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne, të gjithë klubin. Por, është, gjithashtu, për të gjithë që na kanë përkrahur! Faleminderit!", ka shkruar Xhaka në rrjetin social "Instagram".

Paqarada i bashkohet St. Paulit

Mbrojtësi i Kosovës në futboll, Leart Paqarada, i është bashkuar St. Paulit në Bundesliga 2 nga SV Sandhausen, për një shumë prej gati 1 milion eurosh. Pas gjashtë vjetëve qëndrimi në SV Sandhausen në kategorinë e dytë të futbollit gjerman, Paqarada ka kaluar në St. Pauli duke nënshkruar kontratë trevjeçare.

St. Pauli, i cili bën gara në Bundesliga 2 po ashtu, njoftoi në uebsajtin e vet se 25-vjeçari kosovar i lindur në Bremen ka nënshkruar marrëveshje e cila do ta mbajë në klub deri më 30 qershor 2023. St. Paulit i ka kushtuar Paqarada 800 mijë euro. "Gjatë bisedimeve me drejtuesit, ata më vlerësuan lart dhe treguan që kanë besim në mua. Ky klub është me traditë dhe i njohur për atmosferë të veçantë dhe me tifozë madhështorë. Jam i lumtur që tani jam pjesë e St. Pauli dhe mund ta bëj një hap të ri në karrierën tim", ka thënë Paqarada për uebsajtin e klubit gjerman.

Hamiltoni triumfon në Britani

SILVERSTONE, 2 GUSHT - Kampioni në fuqi i Formulës 1, Lewis Hamilton, ka arritur të fitojë sot garën e Shpërblimit të Madh të Britanisë, ani pse në xhiron e fundit atij i ishte shpërthyer gola. Piloti i Mercedesit përfun-

doi 5.856 sekonda para holandezit të Red Bullit, Max Verstappen. I treti doli Charles Leclerc i Ferrarit, që ishte 18.474 sekonda prapa Hamiltonit. Në pozitat katër e pesë u renditën Daniel Ricciardo i Renaultit dhe

Lando Norris i McLarenit. "Ishte mjaft ngushtë", iu drejtua Hamiltoni ekipit të tij nëpërmjet radiolidhjes. Për Hamiltonin ishte triumfi i shtatë në shtegun në Silverstone. Po ashtu, është fitorja e tretë këtë stinor nga

katër gara të zhvilluara. Hamiltoni kryeson renditjen pas katër garave me 88 pikë, 30 më tepër se kolegu i tij te Mercedesi, Valtteri Bottas. Max Verstappen është i treti me 58 pikë.



Berisha: Për Kosovën flas me shumë zemër

PRISHTINË, 2 GUSHT - Valon Berisha është një prej futbollistëve më cilësor që aktivizohet te Përfaqësuesja e Kosovës. Në një intervistë në emisionin "Vera në RTK", Berisha ka treguar një moment të tmerrshëm në karrierën e vet. "E kam pasur një moment, isha 20-vjeçar në Norvegji, nisa të ushtrij në Elfsborg. Pësova lëndim, lëndova ligamentet kruciale. Në atë moment më shkoj mendja se përfundoi futbollit", u shpreh Berisha.

Ndërkaq, duke folur për atdheun, ai ka thënë se emocionohet sa herë vjen në Kosovë. "Kur flas për Kosovën, flas me shumë zemër, kam qenë kudo në botë, por si Kosova nuk ka. Mezi pres të vij në pushimet e të jem në Kosovë", ka shtuar Berisha.



Ai ka zbuluar edhe talentin e tij për muzikë, profesion të cilin do ta bënte në rast se nuk do të ishte futbollist. "Nëse nuk do të isha futbollist, do të merresha me muzikë. Kur jemi me Përfaqësuesen, nganjëherë këndoj unë", ka shtuar Berisha, i cili gjatë kësaj vere u transferua në

skuadrën franceze Reims, aty ku luan edhe Arbër Zeneli. Valoni ka treguar skuadrën e preferuar dhe kampionatin i cili e tërheq më së shumti. "Skuadra që preferoj është Barcelona, por liga që më tërheq më së shumti është Premierliga", ka nënvizuar Berisha.

Lakersat mposhten nga Toronto

LOS ANGELES, 2 GUSHT - U zhvilluan 5 ndeshjet e radhës në NBA, ku spikati përplasja mes kampionëve në fuqi të Toronto Raptorsit dhe skuadrës më të mirë në Perëndim, Los Angeles Lakers, e fituar nga kanadezët 107-92, falë një rezultati të pjesshëm 35-22 në periodën e fundit. Paraqitje super e Kyle Lowry, që realizoi "double double", 33 pikë dhe 14 "rebounde", ndërsa për Lakersin nuk mjaftuan 20 pikët dhe 10 rikuperimet e LeBron Jamesit. Vjen humbja e dytë radhazi për New Orleans Pelicansin, që u gjunjëzua 126-103 përballë Los Angeles Clippersit në një sfidë që praktikisht u mbyll që në pjesën e parë (77-45). Protagonistët e përballjes ishin Paul George me 28 pikë dhe Kawhi Leonard me 24. Oklahoma City Thunderi fitoi 110-94 ndaj Utah Jazzit, me skuadrën e Billy Donovanit që qëndroi gjithë kohën në kryesim, madje me plot 22 pikë diferencë në intervalin mes pjesëve.



REZULTATET	
Denver Nuggets - Miami Heat	105-125
Oklahoma City Thunder - Utah Jazz	110-94
Los Angeles Clippers - New Orleans Pelicans	126-103
Indiana Pacers - Philadelphia 76ers	127-121
Toronto Raptors - Los Angeles Lakers	107-92

Gilgeous Alexander rezultoi më i mirë me 19 pikë, i ndjekur nga Chris Pauli e Steven Adamsi, respektivisht me 18 dhe 16 pikë. I papërmbyjtshëm T. J. Warren, që shënoi rekordin e karrierës në fitoren 127-121 të Indiana Pacersit ndaj Philadelphia 76ers. Plot 53 pikë realizoi "ylli" i

Pacersit, ndërsa në radhët e Sixersit nuk mjaftoi paraqitja e jashtëzakonshme e Joel Embiidit, autor i 41 pikëve dhe 21 rikuperimeve. Bind Miami Heat, që mposhti pa shumë vështirësi 125-105 Denver Nuggetsin. Ndeshje që u zgjidh në periodën e tretë (38-22) nga skuadra nga Florida. Nga 22 pikë realizuan Jimmy Butler dhe Bam Adebayo, ndërsa Denveri pagoi mungesat e Murrayt, Harrisit e Bartonit, përtej lojës së mirë të Nikola Jokiçit (19 pikë, 7 rikuperime dhe 6 asistime).

Pensionohet Wagneri

Ylli gjerman Sandro Wagner ka vendosur t'i japë fund karrierës së tij. Pak vite më parë Wagneri bënte bujë të madhe duke u transferuar te Bayern Munich, por ritmi ishte i rëndë për t'u ndjekur nga ai. Kështu, Wagneri

ka deklaruar së fundmi se do të tërhiqet nga futbollit, duke u falënderuar për të gjitha mundësitë. "I falënderohem futbollit që më ka bërë një jetë kaq të mrekullueshme. Isha i aftë të arrija të gjitha synimet dhe ëndrrat. Ta vishja fanellën

kombëtare më bëri veçanërisht krenar", ka thënë Wagner për "Bild". Wagneri e kaloi sezonin 2018/19 me Bayern Munich, pasi shkëlqente me Hoffenheim. Së fundmi ai luajti me skuadrën kineze Tianjin TEDA.

SHKURT

Ronaldo: Të ecim përpara për titullin tim të tretë me Juven

"I lumtur që fitova titullin tim të dytë radhazi në Serinë A. Duket e lehtë, por nuk është kështu. Vit pas viti, me talent, me vendosmëri dhe me shumë punë mund t'i arrij të gjithë objektivat dhe të jesh gjithnjë më mirë se më parë". Me këto fjalë Cristiano Ronaldo në profilin e vet në "Instagram", feston me fansat këtë sukses në futbollin italian. Ronaldo lëshoi edhe një të dhënë të rëndësishme për të ardhmen e tij: "Tani të ecim përpara për titullin tim të tretë". Në këtë periudhë është folur shpesh për një largim të tij nga Juve në fund të sezonit por, me sa duket, CR7 nuk ka ndërmend ta ndryshojë destinacionin. Ronaldo mbylli sezonin e tij të dytë në Itali në kuotën e 31 golave.

Mulleri lavdëron trajnerin Flick

Sulmuesi i Bayern Munchenit i ka bërë komplimente trajnerit Hans-Dieter Flick. Duke folur për "Süddeutsche Zeitung", sulmuesi e ka krahasuar identitetin e skuadrës aktuale me atë të kohës së Pep Guardiols. "Mënyra jonë e lojës është e dallueshme, njësoj si në kohën e Pep Guardiolas", ka thënë gjermani. "Çdo lojtar shprehet në maksimum për rolin e tij. Kjo bën të mundur që gjithë skuadra të shprehet në nivele të larta dhe të rritet si kolektiv, duke fshehur pikët e dobëta. Luhet si skuadër, nuk ekziston individi. E njihja Flick më parë, por vetëm si trajner të dytë. Nuk imagjinoja që të kishte kaq shumë njohuri. Shikoj lojtarët e rinj shumë të motivuar dhe veteranët që kanë dëshirë të provojnë gjëra të reja. Kjo përzierje mund të sjellë gjëra të rëndësishme...", ka thënë Muller.

Pjaniqi: Mbylla historinë time në Itali, lamtumirën do ta jap më 23 gusht

Futbollisti i Juventusit, Miralem Pjaniqi, përshëndeti tifozët bardhezi pasi ngriti titullin e 36 në histori. Në një mesazh të shpërndarë në rrjetet sociale, mesfushori boshnjak, i cili në sezonin e ri do ta luajë me Barcelonën, shprehu gëzimin për kapitullin e bukur që ka shkruar me Juventusin gjatë këtyre viteve. "Vetëm mendimi për më bën të rrëqethem, por kjo mbrëmje mbyll kapitullin tim në Serinë A me Juventusin. Por, ende nuk ka ardhur koha për ta dhënë lamtumirën. Për këtë do ta pres datën 23 gusht", ka shkruar Pjaniqi në "Instagram".

Rooney: De Bruyne është një nga tre lojtarët më të mirë në botë

Kevin de Bruyne po kalon në një formë jashtëzakonisht të lartë në dy-tri sezonet e fundit me Manchester Cityn. Sipas Wayne Rooney, belgu është një nga tre lojtarët më të mirë në botë. "Ai është një nga tre lojtarët më të mirë në botë tani. Ai shkon në të djathtë dhe luan disa topa të mrekullueshëm në zonë. Skuadrat mendojnë se mund ta shtyjnë atë të luajë në krah, por ai mund të japë topa në hapësirat më të vogla edhe nga aty", ka thënë Rooney. "Do ta kujtoj gjithmonë unë dhe Schneiderlin në 4-4-2 kundër mesfushës me KDB, Silva dhe Fernandinho, me Sterling që futej kohë pas kohe. Po flisim me vete: 'Çfarë po ndodh këtu'. Ata dukeshin më shumë se ne në numra. Ishim 3:0 në disavantazh pas 37 minutave, me 18 % posedim". "Ajo që më pëlqen më shumë është se ai krijon raste, rreziqe, ai nuk shkon për topa të lehtë - luan me pasime të vështira. E shoh se kur ai ka topin, të tjerët fillojnë vrapin, dhe ky është komplimenti më i mirë që mund t'i japësh një mesfushori", ka shtuar Rooney.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



30.07.20

Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal, dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, Komuna e Suharekës ju fton në:

Shqyrtim Publik

Për: **Propozim Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028**

Datë: **07.08.2020 deri më 07.09.2020**

Vendi: **Objekti i Komunës së Suharekës**

Prezantimi i dokumentit nga Komuna e Suharekës do të mbahet:

Datë: **11.08.2020 (E Martë)**

Ora: **11:00**

Vendi: **Palestra sportive "13 Qershori" - Suharekë**

Nr. Org. / Dokumenti / Org.	Nr. Org. / Dokumenti / Org.	Nr. Org. / Dokumenti / Org.	Nr. Org. / Dokumenti / Org.
01	016	32775	2

Komuna e Suharekës ka hartuar Propozim Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028, ku si bartëse e këtij procesi është Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe kompaninë konsulente "INSI" me seli në Prishtinë. Për finalizimin e Dokumentit, para aprovimit final, ky Propozim Dokument shpallet në shqyrtim publik për **30 ditë** para qytetarëve dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara apo që atakohen nga zhvillimi i qytetit në tetë (8) vitet e ardhshme.

Komuna është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshëm të kontribuojnë në përgatitjen e një dokumenti të qëndrueshëm dhe lehtë të zbatueshëm. Andaj, ju ftojme të jeni pjesë e këtij shqyrtimi dhe diskutimi publik, ku pjesëmarrja dhe kontributi juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke ndikuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës në komunën tonë.

Dokumentin mund ta gjeni në linkun: <https://kk.rks-gov.net/suhareke/urbanizem/>

Shqyrtimi publik do të zgjas **30 ditë** nga data 07.08.2020 – 07.09.2020, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, vërejtje apo sugjerime, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe korrektësi të plotë. Komentet mund të dorëzohen zyrtarisht në mënyrë fizike në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim, apo përmes formës elektronike në email urbanizmisuhareke@rks-gov.net dhe sanie.kuqi@rks-gov.net



Kryetari i Komunës:
Bali MUHARREMAJ

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mirsad Elmazi shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

► Luljeta Thaqi shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Arbreshe Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Leke Dukagjini " Prizren.

► Shala Construction" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik 810874025, nrb. 71352897 nr. fis. 601733703

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Drage Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/335
Më: 30.07.2020
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- i rregullt

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU "9 Maji" Rapçë

1. Një mësimdhënësi për muzikë

SHFMU "Zenuni" Brod

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor
2. Një mësimdhënësi për Fizikë
3. Një mësimdhënësi për Biologji
4. Një mësimdhënësi për art figurativ

SHFMU "Svetlost"- Krushevë

1. Një mësimdhënësi për Kimi
2. Një mësimdhënësi për mësim klasor në Zlipotok

SHFMU "Restelica"

1. Një mësimdhënësi për Matematikë
2. Një mësimdhënësi për Fizikë (12 orë)
3. Një mësimdhënësi për Kimi (10 orë)
4. Një mësimdhënësi për Histori
5. Një mësimdhënësi për Gjeografi
6. Tre mësimdhënësi për mësim klasor

SHFMU " 28 Nëntori"- Bresanë

1. Tre mësimdhënësi për mësim klasor (deri sa punëtoret të kthehet nga pushimi i lehonisë)

SHFMU " Shaban Shabani " Llopushnik

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor në Pllavë (deri sa punëtoret të kthehet nga pushimi i lehonisë)
2. Një mësimdhënësi për mësim klasor në Pllavë

SHFMU " Fetah Sylejmani" Dragash

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor në Shajne

SHML "Ruzhdi Berisha" Dragash

Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënësi për lëndë gjuhë shqipe (deri sa punëtori Selim Kryeziu ta përfundon mandatin politik si zëvendës ministër ose nëse emrimi nuk ndërpritët më herët)

Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënësi i lëndës së praktikës profesionale në profilin arsimor Infermjeri i përgjithshëm

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).


Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 30.07.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

v.v _____



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
City Locality	Prishtina
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Selection of an individual consultant for ENVIRONMENTAL AND SOCIAL PERFORMANCE SERVICES IC/ MFK/2020/010
Type of Procurement	Services
Buyer	Millennium Foundation of Kosovo
Publication Date	29 July 2020
Notice Deadline	19 August 2020; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Government of Kosovo has received grant funding of UD\$49 million (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, MFK intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for ENVIRONMENTAL AND SOCIAL PERFORMANCE SERVICES.

The Millennium Foundation Kosovo invites interested eligible individual consultants to submit their technical and financial proposals for the provision of Environmental and Social Performance (ESP) Services on a full-time basis.

The prospective Individual Consultant is expected to commence the ESP Services early September 2020 and the duration of the contract will be for one (1) year precisely until the completion date of the Threshold Program which is September 30, 2021. Should there be an extension of the term of the Threshold Program, the MFK might offer an extension of ESP Services for an additional term, which is subject to the performance of the prospective Individual Consultant.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/selection-of-an-individual-consultant-for-environmental-and-social-performance-services-ic-mfk-2020-010/>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org ,giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **19 August 2020 at 14:00 pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The addresses:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku – MFK Procurement Manager
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	www.millenniumkosovo.org



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Program Management Consultant for Assessment and Supervision Services for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS")
Procurement Ref. Number	RFP / MFK / QCBS / 2020 / No. 002
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services
Employer	Millennium Foundation of Kosovo
Publication Date	29 July 2020
Submission Deadline	07 September 2020; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation of Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Transparent and Accountable Governance Project: Government decision-making is often opaque, leading to distrust by the private sector and civil society, and high perceptions of corruption. Kosovo's judiciary is one the country's least trusted institutions. This project supports also the implementation of a case management information system to make judicial information publicly available, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Program Management Consultant for Assessment and Supervision Services for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS").

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites proposals from eligible consultants for The Public Access to Judicial Information (PAJI) activity, implemented by the Millennium Foundation of Kosovo, aims to support the Kosovo Judicial Council (KJC) by building upon assistance provided by USAID and Norway to implement a Case Management Information System (CMIS) and using that system to improve the administration of justice in Kosovo, transparency of the rule of law institutions, as well as but also support the Kosovo Judicial Council, Kosovo Prosecutorial Council and the Ministry of Justice (MoJ) in improved communication and outreach.

Bidding will be conducted through the QCBS procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Proposal (RFP) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RCQ document shall be published at the latest 5 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement/program-management-consultant-for-assessment-and-supervision-services-for-the-public-access-to-judicial-information-activity-case-management-information-system-cmis-rfp-mfk/>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFP to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org ,giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in RFP rejection. The File link for submission of qualifications is included in the RFP document.

Qualifications shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFP documents no later than **07 September 2020 at 14:00 (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address referred to above is:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	www.millenniumkosovo.org



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales